

Procesverbal

Nga mbledhja e IX- (nëntë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:17.10.2023

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave,
- 3) Kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës nga z.Arzim Alidini,
- 4) Raporti 9-mujor Financiar për vitin 2023, dhe
- 5) Eventuale.

Uran Halimi: Të nderum delegatë, si dhe të gjithë ju të pranishëm, mirë se keni ardhë në Mbledhjen IX të rregullt për vitin 2023 të KK të Dragashit, ku siç e dini dhe keni pranuar materialin në formë elektronike, është paraparë ky rend i ditës: në pikë të parë ka qenë miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; pika e dytë është Miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave; te pika e tretë me radhë është Kërkesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës nga z.Arzim Alidini; pika e katërt është Raporti 9-mujor Financiar për vitin 2023; pika e pestë edhe e fundit është pika eventuale. Para se të kalojmë te rendi i ditës, deshta të ju bëj me dije se dje në KPF është rekomanduar që kërkesë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, domethënë pika e tretë, të largohet nga rendi i ditës, për shkak që e kemi parapa si pikë të panevojshme edhe tashmë Komunë i kish marrë veprimet e nevojshme në lidhje me këtë pikë. Është një pikë të cilën na realisht edhe nuk kemi të drejtë me e shqyrtu. Duhet ta hedhim në votim rekomandimin për largimin e kësaj pike të rendit të ditës. Në lidhje me këtë pikë e ka lyp fjalën z.Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve edhe ju uroj punë të mbarë! Po më shqetëson fakti që - ne jemi delegatë edhe e kemi një rregull që duhet t'i përgjigjja kërkesave të cilat duhet t'i plotësojmë. Kam ardhë prej orës 08:30 – 09:00, deri në ora 10:00 këtu, pesë minuta në dhjetë një delegat ka ardhë, prej orës dhjetë e mbrapa kanë ardhë delegatët tjerë. Në ora 10:30 po fillojmë punën. Kjo është një papërgjegjësi, mos të ndodhë në të ardhmen. Unë nuk kam të drejtë me u përzie, po në ora 10:00 është orari që ne duhet t'ia fillojmë punës. Duhet të kemi përgjegjësi për

punën që e bëjmë. Mediat janë prezente, na shohin neve që në ora 10:00 na duhet me e fillue mbledhjen. Nuk është hera e parë, kjo legjislaturë duhet ta marrë seriozisht punën, duhet me punue. Qe dy muaj s'kemi pas mbledhje edhe dihet, unë jam prej atyre që nuk marrë rrogë fare, nuk është marre me e theksue. Dikush merr ka 700 euro, dikush ka 500 e diçka, dikush nuk merr hiç. Nuk është me rëndësi pagesa, është me rëndësi përgjegjësia, me ardhë edhe me ia fillue punës me kohë. E dyta, sa i përket rendit të ditës, ti kryesues edhe zyrtari ligjor. Kryesuesi e cakton rendin e ditës, kryetari ia çon kryesuesit, kryesuesi e cakton rendin e ditës, ndërsa zyrtari ligjor, ato të cilat nuk janë në përputhje me ligjin duhet me i ndalue, edhe me e sugjerue kryesuesin dhe kryetarin që mos me ardhë në Asamble. Hera e fundit le të jetë, asgjë që nuk është në përputhje me Rregulloren edhe me ligjet mos me ardhë në Asamble, edhe mos me na ardhë neve materiali në momentin e fundit. E dyta, Komisioni i Kuvendit duhet të mobilizohet dhe të kryejë detyrën me përgjegjësi. Edhe kjo hera e fundit, mundin sot ose nesër me u takue edhe këtë punë me e përfundue. Komisioni i Kuvendit për pagesat e rrogave të Asamblesë Komunale. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderum delegat! Sa i përket rendit të ditës, te Ligji për Vetëqeverisje Lokale, te pika ku folet direkt për rendin e ditës, thuhet që rendin e ditës e bën kryetari në bashkëpunim me kryesuesin. Kryetari m'i bjer pikat, unë e thirri seancën. Në këtë rast, bashkëpunimin s'e kemi qaq edhe të mirë, se veç më vijnë pikat e rendit të ditës, unë duhet me e thirrë seancën se e kam obligim ligjor. Dje në Komitet kam protestue edhe unë në lidhje me rendin e ditës, për pikat të cilat nuk i takojnë të jenë në rend të ditës. Po nuk është diçka në dorën time. Kanë ardhë pikat, e kam thirrë seancën. Po kjo nuk është ndonjë shkelje ligjore. Po unë e bije, ju e hiqni, duart i keni, nëse s'doni me e hek mundim me e lonë, qetash e qesim në votim. Sa i përket asaj pjesës së pagave, po besoj që mo e kemi teprue t'u diskutue para qytetarëve. Për qato e kemi themelue Komisionin, e kam pa që kie mungesa – jo i vetmi, ti nuk je, ka mungesa – mirëpo për qat punë është themelue Komisioni. Duhet me pas pak durim, se ka punë, qysh e pamë, edhe në Komision. Ka me u rregullue gjithçka, edhe këtu ka me dalë kryetari i Komisionit për me raportue, edhe në lidhje me mungesat tua edhe të secilit këtu. Tash çdo seancë na po duhet me e diskutue të njëjtën temë, pa ardhë përfundimi. Ta presim përfundimin edhe del në pah gjithçka. Po kur të vendosim na, jemi pjesë e Komisionit, ti bashkë me mu. E zgjidhim atë pjesë edhe dalim raportojmë. Unë po besoj që kurgjo s'ka me të mbet mangu, as ty e as kërkujt tjetër. Puna nuk kryhet kur e pengojsh punën, puna kryhet ku i ndihmojsh punës. Ti e dish që Komisionin e kalum, t'u diskutue tema për të cilat na s'u thirrëm aty në Komision, është shpërbë ai Komision, domethënë nuk zgjati qaq shumë. Nëse unë shkova, ju jeni konë edhe gjashtë anëtarë të tjerë të Komisionit, keni mund me vazhdue. Sidoqoftë, në lidhje me këtë propozim e ka kërkue fjalën edhe z.Nedžmidin Sejdirar.

Nedžmidin Sejdilar: Sa i përket rendit të ditës, mendoj se zoti Xheladini ka të drejtë kur është fjala për pikën e tretë të rendit të ditës për pllacin e zotërisë në fjalë. Kjo kërkesë i është drejtuar drejtpërdrejt kryetarit të komunës. Ajo kërkesë nuk duhej të arrinte në Kuvend. kryetari kishte të drejtë ta zgjidhte vetë këtë problem. Pushteti ekzekutiv kërkon të na hedhë një patate të nxehtë këtu në kuvend, që ne ta zgjidhim dhe jam dakord që t'i kthehet kryetarit dhe pushtetit ekzekutiv, që ta zgjidhin vetë problemin. Ai zotëri po kërkon një parcelë për të filluar biznesin e tij në të njëjtin vend ku autoriteti ekzekutiv po ndërton një park. Qytetarët me këtë rast iu drejtuan dy peticioneve kryetarit të komunës dhe kryetarit të kuvendit, të cilat nuk i morëm këtu. Tani pyes veten nëse kërkesa e individëve është më e rëndësishme se peticioni i qytetarëve, që nuk e kemi marrë këtu. Unë do ta mbështes propozimin për t'ia kthyer kryetarit të komunes për shqyrtim, le ta vendosë ai vetë. Jam dakord me zotin Xheladini që komisioni të hetojë pagesën e mëditjeve dhe mendoj se nuk do ta nxjerin ne shesh vetëm lepurin, por edhe ariun.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër? Shpetim Hajredini e ka kërkuar fjalën.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje i nderuar nënkryetar, drejtor, kolegë e kolege asambleistë, ju qytetarë të nderuar të Dragashit! Unë pajtohem plotësisht me kolegun tim, parafolësin Samidin Xhelaidni, dhe natyrisht po besoj që në seancat e ardhshme, unë personalisht nuk mungoj, po në këtë seancë nja 10 minuta mungova, erdha pak me vonesë. Kërkoj falje! Por është shumë e arsyeshme që ta marrim pak me seriozitet, të jemi më përgjegjës dhe të vijmë me kohë, të fillojmë me kohë dhe ta përfundojmë me kohë. Tjetra për të cilën e mora unë fjalën, ka të bëjë me mosardhjen e materialit në formë fizike. E kam diskutue pak, po më duket, edhe vitin e kaluar, nuk e mbaj në mend nëse kam kërkuar që, po që se kalojmë direkt të na vijë materiali vetëm në formë elektronike, atëherë t'i kemi mikrofonat në pozitat ku ne qëndrojmë gjithmonë, pasi që është jo në rregull dhe nuk i plotësojmë kushtet që ta marrim na lloptopin dhe ta vendosim tash këtu dhe të diskutojmë, të paraqesim ato problemet e qytetarëve para ekzekutivit. Është mirë që të vazhdohet në të ardhmen, të në vijë në formë fizike materiali, derisa Komuna, ekzekutivi të arrijë t'i vendosë mikrofonat në pozitat që ne jemi atje. Besoj që do të kenë mundësi dhe plotësohen kushtet që ta kemi materialin vetëm në formë elektronike dhe të mos na vjen në formë fizike. Besoj që do ta keni parasysh dhe në seancën e ardhshme do ta kemi edhe në formë fizike materialin. Unë jam shumë optimist që kam mbështetjen edhe të kolegëve tjerë asambleistë në këtë drejtim. Tjetra, po ndodh shumë shpesh që, pothuajse u bë traditë, në çdo seancë që po na vjen materiali, një herë na vjen një pjesë, ditën para mbajtjes së seancës na vjen pjesë tjetër shtesë, me përmirësime – jo goxha përmirësime, se aty në të parën goxha lëshime, në të dytën shumë përmirësime, Okej, në rregull është, por është më mirë që kur të na vijë materiali të jetë i kompletuar me herën e parë. Edhe pse

unë në një seancë pata potencue se unë nuk i mbështes mo këto që na vijnë në këtë formë, që nuk na vijnë shtatë ditë para mbajtjes së seancës, siç është ligjërisht, natyrisht unë në këtë seancë nuk e thej premtimin dhe nuk e mbështes. Por, jam i bindur që edhe shumë prej kolegëve të cilët nuk e hapin emailin e tyre çdo ditë, as që e kanë lexue këtë Rregullore që iu ka ardhë dje. Pasi që mora vetëm informacione që s'po e dinë as çka ka ndodhë dhe nuk mund unë t'i akuzoj ata pse nuk e hapin çdo ditë. Na ka ardhë materiali dhe e kemi ditë si të kompletuar. Prandaj, duhet të keni kujdes, ndoshta për ju, ekzekutiv, nuk çon shumë peshë, po për ne çon peshë shumë kjo, se na jena këtu për qytetarët dhe për të mirën e tyre. Duhet ta kemi materialin me kohë, ta lexojmë, ta analizojmë dhe pastaj të dalim këtu, të dimë çka të themi, ta mbështesim apo ta kundërshtojmë. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit shumë! Kem t'u folë për propozimin për largimin e pikës së tretë të rendit të ditës. Për këto problemet që po ngjallen tashmë, e kemi edhe pikën eventuale, është mirë me e respektue. Lypin respektim, lypin transparencë, edhe nuk e respektojnë as Rregulloren e Kuvendit e as neve si delegatë. Kur flasim për një çështje, është mirë me respektue çështjen për të cilën po flasim, edhe me folë e me kërkue fjalën në lidhje me atë çështje, me atë pikë të rendit të ditës. Nëse s'keni diçka për me shtue në lidhje me largimin e pikës së tretë nga rendi i ditës, atëherë e hedhim në votim propozimin që është marrë dje në KPF. Kush është pro këtij propozimi? Kush është kundër? Abstenim? Me 15 vota pro, me 7 kundër edhe me zero abstenim, kalon propozimi i z.Loshaj që kjo pikë të largohet nga rendi i ditës. Po vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, pa pikën e tretë. Nëse doni me e marrë fjalën dikush në lidhje me rendin e ditës, pa përfshirë pikën e tretë, mundeni. Sejdilar e ka kërkue fjalën. Për rendin e ditës, Nedžmidin!

Nedžmidin Sejdilar: Qe kryesues, për rendin e ditës, po e shoh shërbimi i Kuvendit po shpërndan do dokumenta. Po më doket për rendin e ditës janë këta. Këtu s'ka kurgjo strikt. Qe kryesues për rendin e ditës, një pyetje për ty, a ban, direkt? Çka është qeky dokumenti, pse kaq me vonesë edhe pse unë s'e kam me vakt, qysh të debatoj, qysh të përgatis veten për seancë?

Uran Halimi: Nuk është ky dokumenti që i përket rendit të ditës. Kjo është një kërkesë të cilën z.Loshaj ia ka bo dje drejtori të Financave dhe ka kërkue numrin e bizneseve, ka kërkue llogaridhënie, besoj që qajo është. Sa i përket rendit të ditës, nuk ka ndonjë diskutim po besoj. Atëherë e qesim në votim këtë rend të ditës, pa pikën e tretë. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Kemi 16 vota pro, 1 kundër edhe 9 abstenime, kalon rendi i ditës kështu si është. Po vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës, e kemi miratimin e procesverbalit. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me procesverbalin? z.Driton Ademi e ka kërkue fjalën.

Driton Ademi: Falemnderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kryesues, e kam një vërejtje, ta quaj, për ty. Në mbledhjen e fundit që e kemi mbajt, e kam bo një propozim për shtyrjen e Vendimit

të Pompës.

Uran Halimi: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar është pika e rendit të ditës.

Driton Ademi: Po, jam t'u folë për qeto. Unë e kam bo një propozim në mbledhjen e kaluar, domethënë, propozimi im nuk ka dalë në votim. Është shkelje e Rregullores së Punës së Kuvendit. Çdo delegat ka të drejtë me propozue edhe e kие si detyrim me e qit në votim. A kalon apo nuk kalon, është e drejtë e secilit delegat, po ti e kие obligim me i qit në votim propozimet të cilat delegatët i propozojnë.

Uran Halimi: A kие vërejtje për procesverbalin?

Driton Ademi: Vërejtje kam që nuk e ke qit në votim edhe nuk po e shoh unë qetu, domethënë që nuk është në procesverbal. Unë kam kërkuе diçka, po ti nuk e ke qit, s'di sa je t'u kuptue?

Uran Halimi: Domethënë, propozimi që e ke bo nuk është në procesverbal?

Driton Ademi: Jo jo, është në procesverbal, po ti nuk e ke qit në votim. Propozimin tim nuk e ke qit në votim.

Uran Halimi: S'po më kujtohet.

Driton Ademi: Mundish me lexue, por sa s'je i ndërgjegjshëm që s'e ke lexue procesverbalin e Kuvendit, atëherë mundish me hi me lexue, nashta e shohish. Jo, nuk e ka qit hiç në votim.

Uran Halimi: Okej, a e kreve? Falemnderit shumë! Dikush tjetër a do me folë në lidhje me procesverbalin nga mbledhja e kaluar? Po vazhdojmë, po e hedhim në votim. Kush është pro pikës së parë, te miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 26 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim, konga procesverbali në rregull. Po vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës, është miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave. Nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me pikën e dytë të rendit të ditës? Fjalën e ka kërku drejtori Nuhija Tairovci.

Nuhija Tairovci: Përshëndetje të gjithëve, ju keni marrë një version të rregullores. Kërkoj falje për gabimin e shkaktuar nga disa procedura. Dje e keni marrë me vonesë versionin përfundimtar të rregullores. Ky rregullore është hartuar me mbështetjen e organizatës qeveritare japoneze JICA, e cila është e pranishme në rajonin tonë. Versioni përfundimtar i rregullores është shqyrtuar nga Bordi i Drejtorëve. Më pas, rregullorja është dërguar në seancë publike për një muaj, ku të gjithë qytetarët kanë pasur mundësi të japin komentet dhe shtesat e tyre. Do t'ju prezantoj me disa propozime që duhet të merren parasysh për shqyrtim të mëtejshëm, duke pasur parasysh se jeni ju ata që duhet të miratoni këtë rregullore. Neni 6.20 thotë se komuna do të organizojë grumbullimin e mbeturinave të ngurta të paktën tre herë në vit, dhe propozimi është që të shkruhet së paku një herë. Nëse ka nevojë

për më shumë, mund të bëhet gjithmonë. Neni 14.4 thotë se pagesa e tarifës për mbeturina bëhet në institucionet financiare në një llogari specifike xhiro të komunës së Dragashit dhe propozimi është që të bëhet nëse komuna nuk merr një vendim tjetër. Në nenin 15.5 thuhet se ky konfirmim bëhet përmes paraqitjes për inspektim nga një zyrtar komunal në qendrën për shërbime të qytetarëve dhe propozimi është që kjo qendër për shërbime të qytetarëve të ndryshohet dhe t'i shtohet drejtorisë për shërbime publike. Neni 26.5 thotë se Kryetari bashkëpunon me ministrinë dhe donatorë të ndryshëm, propozimi është që të shtohet, me një ministri të caktuar dhe të vazhdohet. Në nenin 30 thuhet se pas miratimit nga kuvendi i komunës së Dragashit, kjo Rregullore hyn në fuqi nga janari i vitit 2024 dhe është dashur të hyjë nga janari i vitit 2025. Është një propozim tjetër që duhet të shtohet pas konfirmimit të ligjshmërisë nga organi mbikëqyrës i Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale dhe gjashtë muaj pasi Ministria e Financave të miratojë ligjin për shtimin e stafit si dhe të mbulojë shpenzimet e zbatimit për vitin e parë. Dhe së fundi, është një propozim tjetër, shtimi i nenit 31, ku thuhet se Aneksi A i këtij rregulloreje do të hyjë në fuqi menjëherë pas përcaktimit të ligjshmërisë nga autoritetet mbikëqyrëse të ministrisë. Gjithashtu, dua të bëj një korigjim në aneksin A, bizneset me sipërfaqe 1 deri në 20, duhet të lexojnë nga 1 deri në 30. Bizneset me sipërfaqe zyre 21 deri në 50 janë në rregull dhe në fund një biznes me një sipërfaqe prej më shumë se 51. Dhe në fund të tabelës ka një tarifë minimale për pastrimin, pastrimin dhe larjen duhet shtuar larje. Kaq pata për propozim ndryshime. Unë do t'i shënoj të gjitha komenmtet tuaja dhe nëse është e nevojshme për njoftim shtesë, jam këtu, falemnderit.

Uran Halimi: Falemnderit, drejtor! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërku Driton Ademi.

Driton Ademi: Falemnderit, kryesues! Një pyetje paraprakisht për drejtorin, nëse ka mundësi. A kemi mundësi ndërhyrje për çmimet, domethënë te tabela e tarifave. Në diskutim nëse është, atëherë deshta te tarifat e taksës së mbeturinave që do të caktohet në bazë të hapësirave të objekteve. Tash, bizneset me hapësirë prej 1-20 metra katrorë, unë deshta me e shtue prej 1-50 metra katrorë, edhe të jetë shuma 5.50 euro. Është si propozim domethënë, jam duke bërë propozim. Këtu është e paraparë 1-20 metra katrorë, a deri në 30. Atëherë, propozimi im është 1-50 metra katrorë, të jetë prapë çmimi 5.50 euro. Bizneset me hapësira prej 51-100, nga 10 euro në 8 euro. Nëse dona na me i mbështet bizneset, duhet me ia ulë çmimin, jo me jau rrit çmimin. Te bizneset me hapësira mbi 101 metra katrorë, nga 15 euro në 12 euro. Tarifat minimale për institucionet publike me bizneset e zhvilluara, të caktohet kontratë individuale me ofertuesit e shërbimeve. Kostoja e kontenierit, në metër kub domethënë, 1 metër kub nga 13 euro zbrajje në 10 euro. Kostoja e kontenierit 7 metër kub, nga 50 euro në 40 euro. Tarifat minimale për shkolla, te 1 metër kub që është për 0.15 euro, unë po kërkoj

që të zvogëlohet për shkolla, në 0.12 euro. Tarifat për institucionet tjera, zyre lokale stacionet policore, ambulanta etj., nga 0.15 euro në 0.12 euro. Dhe tarifat minimale për pastrimin e qytetit – që thaje, në mos gabofsha ujë, a s’di çka e përmendi drejtori – pastrimi për metër katror, 1 metër katror 0.15 euro. Kjo është luks, pastrimi është luks, pak a shumë. Mundim na edhe me ia rrit, me çue edhe ni propozim në 0.20 euro. Qeto i kam propozimet për tarifat për shërbimet komunale. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, z.Ademi! Fjalën e ka kërkue z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Përsëritje edhe një herë për të gjithë! Natyrisht se një Rregullore e tillë, po të na kishte ardhë si duhet, në momentin e duhur, meriton mbështetje të patjetërsueshme, pasi që rregullon shumë gjëra të cilat, për momentin, janë të dalura prej binarit, sa i përket pastërtisë në tërësi në territorin e Kosovës, e natyrisht në veçanti në qytetin e Dragashit. Unë nuk do të diskutoj për nenet, do të kaloj direkt te tarifat, por jo – pasi që kolega im dha shifrat dhe bëri një propozim – nuk do të bëj ndryshime. Por, do të kërkoj që patjetër, i nderuar kryesues, ta kesh parasysh që të hedhish në votim, mos harro, se është propozim. Tek vërejtjet, na është dërgu dhe ndërtesat fetare janë përjashtuar nga tarifat për largimin e mbeturinave. Jam i pajtimit. Dhe nën dy, përfituesit e ndihmës sociale janë përjashtuar nga tarifat e grumbullimit të mbetjeve. Gjithashtu, mbështes edhe këtë propozim. Mirëpo, unë bëj propozimin tim dhe i cili besoj që është shumë i arsyeshëm, pasi që edhe këto familje kanë nevojë që ne si Komunë t’u gjendemi pranë. Janë familjet e dëshmorëve, invalidë të luftës dhe veteranë të UÇK-së. Me mundësitë tona komunale, në këtë drejtim kish qenë shumë e arsyeshme që edhe këto tri kategori të jenë përfituese, siç janë familjet të cilat janë me ndihmë sociale. Prandaj, unë kërkoj që propozimi im të dalë në votim. Ata të cilët menojnë që e kam gabim, kanë mundësi edhe të votojnë kundër. Të tjerët të cilët besojnë që është e arsyeshme, le ta votojnë pro, pasi që edhe këto familje kanë kontribue që ne sot ta përjetojmë këtë liri. Gjithashtu, do të kthehem mbrapa pak, në pikën e rendit të ditës të cilën, unë realisht besoj që e kam dëgjue, por – e di që nuk kam të drejtë po duhet të ma lejoni këtë të drejtë në këtë moment. E dëgjova që thaje atë kërkesën e atij zotnisë, që e ka bo për atë tokën, Artani e ka bo propozim. A jam gabim a jo? Unë me sa e di, nuk e kam ditë që e ka bo Artani, m’u duk se në fillim thaje kryetari. Po shpresoj të jam gabim unë, po e lëmë, nëse ka qenë e Artanit, atëherë do kishte qenë rrjedhojë tjetër e votimit, e kryetarit ka qenë diçka tjetër. Megjithatë është mirë, kthehemi në procesverbal dhe e shohim çka ka ndodhë. Nëse jam gabim, të kërkoj falje. Nëse s’jam gabim, atëherë duhet ta kesh parasysh, të kesh kujdes kur e japish një prononcim. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, z.Hajredini! Propozimi po më pëlqen. Sa i përket pjesës jashtë temës, domethënë, është qashtu qysh kam thënë. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Realisht, unë emrin

e ceka, po i atij mendimi të propozimit të tij jam konë edhe unë. E di edhe z.Loshaj edhe ata anëtarët që kemi qenë dje në KPF. Edhe unë kam protestue edhe kam pas dëshirë që kjo pikë me u largue. Në fakt, e kam mbështet këtë propozim. Sidoqoftë, është procesverbali, ekziston, edhe mundim me e zgjidhë. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën përpara se me dalë drejtori? I kemi edhe dy këkresa për fjalë. E kemi z.Miralem Rahte.

Miralem Rahte: Pershendetje te gjithëve, po pyes drejtorin nese pervec kesaj rregulloreje keni nje plan te vecante per perfshirjen e atyre fshatrave qe nuk jane te perfshira ne sistemin e grumbullimit te mbeturinave. Faleminderit.

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka z.Munir Jonuzi.

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve, nuk është keq të kemi në rend dite një rregullore të tillë. Kjo rregullore është e dobishme për komunën tonë. Sa i përket anës teknike, ky rregullore është një rregullore jashtëzakonisht e dobët, ishte e vështirë për t'u lexuar, letrat ishin të gjata. Kemi disa gabime në përmbajtjen e rregullores, për shembull përkufizimi i mbeturinave përsëritet dy herë. Si dhe përkufizimi i menaxhimit të mbetjeve. Sa i përket përmbajtjes së vetë rregullores, kam disa dyshime, sugjerime, shtesa. Në nenin 6, kur flitet për përgjegjësitë e komunës, që tregon seriozitetin e këtij autoriteti për zgjidhjen e problemit me mbeturinat, pika 6 thotë krijimi i një sistemi financiar stabil, disa komuna në Kosovë kanë arritur të krijojnë një sistem financiar stabil. kur bëhet fjalë për menaxhimin e mbetjeve. Këto janë komuna të forta dhe të pasura. Komunitat që kanë burime të mëdha vetanake, siç është komuna e Prizrenit. Me to, përqindja e arkëtimit është rreth 70%. E cila konsiderohet se menaxhon mirë mbetjet. Në këtë mënyrë, me të ardhurat e tij të mëdha, ai mund të kompensojë humbjen prej 30%. Një komunë e varfër si kjo e jona, kjo humbje prej 30% do të ishte katastrofike dhe do t'i kishim borxh operatorit që depoziton mbeturinat tona. Ne nuk kemi shumë të ardhura tona për t'i mbuluar, nesër mund të përfundojmë në gjykatë, përmbaruesi blloko i llogarinë dhe do të ishim jofunksionalë. Neni 6.7 thotë të identifikohen të gjitha deponitë ilegale dhe të parandalohet përhapja e tyre. Mendoj se fillimisht duhet të identifikojmë të gjitha deponitë ilegale dhe fillimisht duhet ta bëjë kompania që po merret me këtë çështje. Pra le të fillojmë me miratimin e rregullores pas kësaj. Brenda paragrafit 16, duhet të sigurohen kushte për operatorët publikë dhe privatë. Mendoj se duhet të kthehemi te qytetarët, sepse janë ata që do ta financojnë gjithë këtë. Mendoj se bashkia duhet të merret me kushtet e grumbullimit të mbetjeve të vetë përdoruesve. Shumë prej tyre i mbajnë mbeturinat për pesë ose gjashtë ditë në qeset e tyre plastike. Kafshët i gërmojnë ato mbeturina, i shpërndajnë kudo dhe pastaj nuk kemi një mjedis ekologjikisht të shëndetshëm dhe të pastër. Prandaj sugjeroj që në kuadër të buxhetit që do të planifikohet për vitet në vijim, të ndajmë një buxhet ku të mund të blejmë kosha, fillimisht për përdoruesit rezistent dhe më pas për të gjithë

të tjerët. Neni 6. 20, që flet për mbetjet e ngurta, parashikohet dy herë në vit, sugjeroj që të mbeten dy herë, jo siç sugjeroi drejtori. Për të përcaktuar se kur do të jetë, për shembull java e parë e majit apo java e fundit e korrikut, kur përqendrimi i popullsisë është më i lartë dhe për rrjedhojë qytetarët do të përfitonin më shumë. Metoda e grumbullimit të mbetjeve derë më derë është e shkëlqyer. Duke marrë parasysh strukturën e popullatës sonë, a është e realizueshme për kompaninë për shkak të konfigurimit të terrenit, sidomos të pjesës së Gorës. Të gjitha fshatrat në Gorë janë kodrinore, ka ngjitje të mëdha dhe është shumë e vështirë të lëvizësh me vetura dhe jo me kamionë, sidomos në dimër. Prandaj disa fshatra nuk pastrohen për dy-tre muaj. Çfarë do të ndodhë me ata muaj në të cilët operatori nuk mbledh mbeturina, sepse është e pamundur. Neni 12 thotë se dokumentet e identifikimit përdoren për regjistrim dhe në versionin tonë në gjuhën boshnjake shkruan njoftim, pasaportë. Unë e kuptoj pse pasaporta, por nuk mund ta kuptoj se çfarë është njoftimi. Më intereson sa do të jetë kompensimi për mbetjet e ndërtimit. Neni 16. 2 ku thuhet se shkalla e kompensimit do të rishikohet çdo dy vjet nga drejtoria kompetente. Duke marrë parasysh performancën e koleksionit. Nuk më pëlqen kjo sepse nëse tarifimi 80% nuk i plotëson nevojat tona, atëherë ne do të rrisim çmimin për të mbuluar atë humbje prej 20% për ata që nuk paguajnë. Neni 17 parashikon që operatori duhet të jetë i licencuar, ai do të shtonte se këtu operatori nuk ka të drejtë t'ia kalojë kompetencën operatorëve të palicencuar apo palëve të treta. Mendoj se kemi shumë dyshime për këtë rregullore dhe duhet të kemi një diskutim serioz me operatorin aktual. Dhe le të shohim se si është plani i tyre për të përfshirë të gjitha fshatrat në sistemin e grumbullimit. Një shembull i qartë i mospagesës. Tani duhet të shohim se cili është problemi me fshatrat e tjerë. Mendoj se këtë rregullore duhet ta shtyjme edhe për një arsye tjetër, asnjë qytetar nuk ka marrë pjesë në mbledhjen publike të 2 tetorit, ndoshta qytetarët tanë nuk e ndjekin ueb faqen e komunës, ka pasur njoftim se takimi publik do të mbahet. Me këtë sugjeroj që të ftojme përfaqësuesit, kryetarët e të gjitha fshatrave të komunës sonë, duhet t'i ftojme dhe të bisedojmë dhe të dëgjojmë mendimet, propozimet e tyre dhe të gjejmë një mënyrë të përbashkët për ta tejkaluar gjithë këtë. Ne nuk mund t'i kërcënojmë qytetarët me zbatues publikë pa pasur idenë e tyre. Një nga sugjerimet e mia është që kjo të shtyhet për në seancën tjetër, për shembull, rregulloren për subvencionet e kemi pasur në rend dite tre herë. Mendoj se duhet të flasim me qytetarët dhe kur çdo gjë të jetë në rregull, atëherë duhet të adoptojmë një Rregullore të tillë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Jonuzi! Nedžmidin Sejdilar e ka kërkue fjalën.

Nedžmidin Sejdilar: Përshëndetje të gjithëve, jam i të njëjtit mendim siç tha zoti Jonuzi, që kjo rregullore të shtyhet deri në një nga seancat e ardhshme të kuvendit. Por para kësaj, ne duhet të plotësojmë disa kushte për të votuar për këtë. Që do të thotë se para se ta çojmë këtë rregullore në kuvend për votim, jam i mendimit se duhet të organizojmë debate publike me përfaqësues të

keshillave të fshatrave dhe njëkohësisht të përfshijmë propozimet që ne si delegatë i kemi paraqitur këtu për këtë rregullore. Kështu në një paketë do të votojmë një rregullore të mirë që nuk do të jetë në dëm të qytetarëve tanë.

Sefidin Mejzini: I nderuar kryetar, të nderuar të pranishëm, përshëndetjë për të gjithë! Edhe ne si Grup i LDK-së e përshëndesim, është një Projekt Rregullore për Menaxhimin e Mbeturinave që është dashtë shumë më herët të bëhet. Ky vendi ynë e meriton me qenë i pastër, ne njihemi për ajrin e pastër edhe për bukuritë. Por kështu, më falni në shprehje, bërlllog është kahmos. Duhet ta bëjmë të pamundshmen që të kalojë sa më mirë. Tash, janë disa çështje që duhet të ngriten edhe kisha kërkue prej drejtorit aktual me na dhënë disa sqarime te këto kuotat e çmimit, te hapësirat, deri ku lejohet, domethënë me shku deri te minimumi. Ekonomia është para kolapsit, shumë lokale janë duke falimentuar, se nuk e kanë vetëm këtë, por e kanë qiranë mujore, e kanë punëtorin, i kanë tatimet në fitim që i paguajnë çdo muaj, çdo tre muaj, tash edhe kjo e mbeturinave. Ka lokale që paguajnë 8 euro, 10 euro, lokali është as 30 metra katrorë. Tash duhet të kemi shumë kujdes, ta japim kontributin të gjithë që kjo të dalë sa ma e pëlqyeshme, që mos t'i dëmtojmë shumë. Por, normal, një menaxhim i mirë i duhet këtij vendit. Atëherë, kisha kërkue të gjithë që ta japin kontributin, por edhe një sqarim prej drejtorit aktual, te kjo pjesa e kuotave të hapësirës, te çmimi, deri ku mujm me bo ndryshime? Të japim disa sqarime, se është një send që na po e votojmë. Falemnderit!

Nuhija Tairovci: Propozimi i parë ishte ndryshimi i aneksit të kësaj rregulloreje, më duhet t'ju them se ky është një version i vjetër i modifikuar që ka disa vite që është në fuqi. Ai version kishte pikërisht atë që keni në versionin tuaj të rregullores. Tashmë kemi rritur sipërfaqen. Më vjen keq që nuk e kam versionin e vjetër këtu, sepse nuk e mendoja se do të kishte kaq shumë diskutime. Kemi ulur shumë çmime në katër ose pesë artikuj. E kemi zbritur nga 24 euro në 20 euro, e kemi ulur për diasporën në 15 euro, pra kemi reduktuar hapsirat që kanë qenë 20 metra katrorë, kështu që mendoj se kjo është një rregullore shumë e përshtatur për qytetarët. Rregullorja e përgjithshme që është bërë në nivel rajonal, çdo rajon është inkorporuar me modifikime që kanë qenë në përputhje me nevojat e komunës, ka pasur kategorizim të ndryshëm. Ku thohet punëtori, pastičeri dhe aktivitete të tjera, i kam shqyrtuar dhe në komision kam bërë një propozim që të ruhet forma e vjetër e rregullores. Do të ishte shumë gjithëpërfshirëse. Ju jeni ata që do të votoni, por mendoj se duhet të bëjmë një paralele me rregulloren e vjetër dhe do të shohim që në krahasim me rregulloren e mëparshme çmimet janë ulur shumë. Unë jam absolutisht dakord me propozimin e kolegut që kërkon të përfshihen tre kategori të reja të veteranëve të luftës... dhe nuk kam asnjë kundërshtim për këtë. Miralem bëri një propozim për të bërë presion për shtrirjen e sistemit të pastrimit në të gjitha fshatrat. Kjo është në fakt sfida më e madhe dhe ky rregullore duhet ta ndihmojë atë proces në shumë mënyra. Të stimulohet Eko regjioni,

i cili aktualisht nuk ka kapacitete të mjaftueshme dhe nuk ka kapacitete të mjaftueshme teknike apo njerëzore për të menaxhuar plotësisht të gjithë komunën dhe për të mirëmbajtur të gjitha fshatrat. Me mbështetjen tonë dhe mbështetjen e organizatës qeveritare japoneze, ne ndihmuam fshatin Brod që më pas t'i bashkohet këtij procesi. Eko regjioni nuk ka mjete teknike dhe mjete të mjaftueshme për të përfshirë të gjitha fshatrat në këto procese. Dje përmenda fshatin Radeshë, ku po pastrohet vetëm 40% e fshatit. Dhe tek ne renditet si fshat i mirëmbajtur rregullisht. Po mbetjet e atij 60%, ndoshta janë në ndonjë deponi të zezë. Kemi rreth 100 deponi ilegale. Këto janë pika të zeza, ku njerëzit hedhin mbeturinat e tyre. Jam dakord me propozimin për pastrimin e këtyre vendgrumbullimeve ilegale nga Eko Rajoni dhe për të bërë presion mbi popullatën për t'u futur në këto procese të reja. Në lidhje me fondet për të cilat foli Munir, nëse ka një tranzicion që komuna kryen pagesat dhe në përputhje me nenin që u shtua më vonë, nëse Ministria e Financave siguron fonde për punësimin e personave të rinj që do të menaxhojnë këtë procedurë, nëse fonde janë parashikuara për vitin e parë, atëherë supozoj se do të kemi kontratë me operatorin dhe do të tarifojmë sipas asaj kontrate. Ai përmendi mbeturinat ndërtimore, ju keni votuar këtu për një vendim për parcelat e caktuara për përcaktimin e mbeturinave ndërtimore, kur të vijë koha do të diskutojmë dhe do ta përcaktojmë çmimin për tarifimin e mbeturinave ndërtimore. Rishikimi i tarifës çdo dy vjet, u përmend, se nëse ka presion nga niveli shtetëror, kjo rritje në 5.5 nuk ka ardhur sepse ka qenë vullneti i komunes apo sepse ka insistuar Eko regjioni. Më besoni, asnjë komunë nuk ka çmim nën 6.5 euro. Duke pasur parasysh se komuna jonë kishte të drejtë ekskluzive dhe se me përpjekjet e Kryetarit ky çmim u ul nga 6.5 në 5.5. Ky reduktim është në interes të qytetarëve. Ne do t'i përfshijmë të gjitha sugjerimet dhe shtesat tuaja në rregulloren tonë dhe patjetër do të keni dokumentet përfundimtare për votim. Në fillim thashë në këtë drejtim, që të mendoni dhe të vendosni nëse ka nevojë për ndryshime shtesë tarifore. Tashmë kemi ulur tarifat. Tashmë i kemi ulur çmimet. Ne në Bordin e drejtorave tashmë kemi ulur sipërfaqen dhe kemi ulur çmimet që ishin në rregullore.

Uran Halimi: Drejtor, veç pak! E kemi edhe propozimin për tarifat që e boni Driton Ademi, që i përmendi hapësirat edhe çmimet këtu. Nëse duesh me ta rikujtu, ka thënë që bizneset edhe hapësirat prej 1-30 metra katrorë me bo prej 1-50 metra katrorë...

Uran Halimi: Në rregull. Falemnderit, drejtor! Fjalën e ka kërku z.Agron Gashi.

Agron Gashi: Ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje kryetar, përshëndetje për juve kryesues! Unë një ndërlidhje të shkurtër lidhur me këtë temë diskutimi. Do të koncentrohem direkt te deponitë ilegale, të cilat janë të shumta në Komunën tonë. Është një numër i konsiderueshëm, por në këtë Asamble Komonale kam folur pak më parë, në mbledhjet e kaluara, se mungojnë shumë gjëra, duke u nisur nga tabelat informuese të cilat lajmërojnë qytetarin për moshudhjen e tyre. Këto tabela

mungojnë nëpër shumë vende. Duhet Drejtoria, Komuna të marrë masa të vë nëpër ato vende, lokacione ku janë këto ilegale që po funksionojnë. Mandej, çështje tjetër me rëndësi, ne ndonjëherë nuk mund të vetëdijesohe mi pa ndonjë ndëshkim. Unë konsideroj se edhe Inspektoriati komunal duhet të jetë në funksion për të tërhequr vërejtjen apo edhe të shkruan ndonjë dënim për të gjithë ata ta papërgjegjshëm të cilët bëjnë ndotjen e ambientit. Meqenëse sot po i kushtohet shumë një rëndësi e madhe në nivel global ndotjes së ambientit, atëherë ne duhet të jemi më syçelë dhe të veprojmë më shumë. Këtë ditë vikendi isha te vendi i quajtur turistik, te Liqeni i Breznes. Aty unë ju siguroj se kemi vizitorë nga e gjithë Kosova. Pikërisht para meje u ndal një familjar nga Drenica, më pyeti a është ky Liqeni. Po, i thashë, ky është. Çfarë të sheh në atë Liqen, të sheh vend turizmi apo të sheh një vend të thuash të deponisë! Të gjuajtur mbeturina gjetiu, mandej edhe ata kontenierët të paktë që ishin, ishin të stërm bushur. Kështu që, kryesia e fshatit kemi kërkuar nga kryetari që jo vetëm për fshatin Brezne si vend i turizmit, por edhe në pikat tjera, si Brodin, Restelicën dhe pika tjera ku ekzistojnë në këtë trevën tonë, si vend turistik, të angazhohen punëtorë shtesë me pagesë. Besoj që, të paktën në ato vende ku janë frekuentuese, të shihen si një imazh dhe një pasqyrë e mirë, të pastruar. Me keqardhje them se ishte gjithçka një imazh i keq, më erdh keq që e pa në atë pozitë vendin apo Liqenin i cili është një liqen i vetmi në Kosovë natyral, po mund të thuash ballkanik. Të paktën ky vend meriton të ketë një punëtor, me një gjysmë norme apo me normë të plotë, me pagesë nga Komuna, që të jetë i angazhuar rregullisht. Unë vetë, me gjithë kryesinë e fshatit, kam qenë aksionar tri herë brenda këtij viti jam ndalur për të pastruar, për të prerë barishta, të cilat ato brenda dy jave prapë rriten. Ai vend ka nevojë për një punëtor të angazhuar, i cili do të përkujdeset për prerjen e tyre, pastrimin dhe njëkohësisht mbledhjen e mbeturinave, me qëllim që ne të krijojmë një imazh më të mirë. Gjithashtu, neve na mungojnë edhe broshurat në këtë drejtim, lidhur me inkasimin e parave dhe mjeteve të mbeturinave. 500-600 shtëpi në kuptimin e inkasimit janë tepër dobët. Mungojnë informacione se çka më tej. Pastaj edhe këto ndryshime tash që po i sjellim, këto rregulloret e reja, pajtohem me zv/kryesuesin që tha se informacionet janë të mangëta, dhe duhet që në mbledhjet e ardhshme të jepet informacion më shumë, një personel ma adekuat komunal, së bashku me përfaqësuesit e fshatrave të mbajnë debate me qytetarë dhe të marrin informacion më të mirëfilltë se çka më tej për ndryshimet rreth funksionimit të deponive. Unë kam përmendur shumë herë, deponia ekzistuese që ekziston atje, janë hedhur mbeturina pa mbulesë, eskavatori nuk ka punuar dhe ka ndotur komplet biodiversitetin natyror, që është i dëmshëm për shoqërinë, për rrethin dhe sëmundjet infektive që mund t'i marrin. Uroj që e ardhmja të jetë më e mirë, tashti rryma është duke shkuar deri në atë deponi, janë duke u vendosur shtyllat, uji gjithashtu është siguruar deri atje, ka filluar të merr veten. Mirëpo, në këtë vend ku po jetojmë dhe veprojmë duhet të punojmë edhe më shumë në këtë drejtim që t'i informojmë qytetarët të jenë më të përgjegjshëm pak në këtë drejtim. Falemnderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Gashi! Fjalën e kërkoi kryetari pak më herët.

Bexhet Xheladini: I nderuar kryesues, zv/kryesues, të nderuar asambleistë, përfaqësues të OSBE-së, mjete të informimit dhe ju të tjerë! Ju përshëndes, ju falënderoj për pjesëmarrje në këtë Asamble dhe në debatin që po zhvillohet lidhur me menaxhimin e mbeturinave në nivel komunal. Duke u bazuar në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, si dhe duke u bazuar në faktin se ne si Komunë jemi vend turistik edhe kemi nevojë për një ambient të pastër, në bashkëpunim me JICA-n japoneze dhe komunat e Regjionit të Prizrenit – Malisheva, Rahoveci, Dragashit, Prizreni dhe Suhareka – i kemi hy procedurës së ndryshimit të mënyrës së menaxhimit të mbeturinave komunale. Ne jemi komuna e fundit e cila po miraton Rregulloren për Menaxhimin e Mbeturinave. Ne e kemi lënë me qëllim që të jemi të fundit, për arsye se i jemi frikësuar procesit të transferimit të menaxhimit të mbeturinave nga ‘‘Ekoregjioni’’ në Komunë. Kjo për shkak se jemi komunë e varfër, me pak të hyra. Mirëpo, ligji na obligon, qytetarët na obligojnë që ne të punojmë që ta kemi komunën e pastër. Ne jemi pajtuar që edhe ne, si të gjitha komunat e Regjionit, të merremi me hartimin e kësaj Rregulloreje, duke i marrë për bazë të gjitha rregulloret e të gjitha komunave të Regjionit, dhe duke u bazuar në rregulloret e tyre na kemi nxjerrë një Rregullore që është shumë më e përshtatshme, për arsye se kemi pa lëshimet e atyre rregulloreve, dobësitë dhe këtë rregullore ia kemi përshtat edhe kushteve të Komunës sonë. Disa prej atyre janë ato të cilat i përmendi drejtori, për ndryshimet që duhet të bëhen dhe që mendimi im është që ju duhet t’i pranoni. Unë nuk do t’i përmendi ato që i tha drejtori, por dua të sqaroj se kjo Rregullore rregullon menaxhimin e mbeturinave dhe i kalon kompetencat nga ‘‘Ekoregjioni’’ dhe nga kompania lokale në komunë, ku në të gjitha këto nene, nëse i keni lexue, përshkruhet qartë cilat janë kompetencat e Komunës, cilat janë kompetencat e operatorit ekonomik të licencuar për menaxhimin e mbeturinave, cilat janë detyrimet e qytetarëve, masat ligjore etj. E pashë që këtu ka kërkesa prej asambleistëve që shtojca A të ndryshohet. Komisioni i cili është formuar nga kryetari dhe pastaj që është debatue në bord, dhe pas sa që është mbajti debati publik me qytetarë për një muaj, dhe pas debatit publik prapë është mbajti një takim, ne kemi bërë disa ndryshime te shtojca A. Jemi komuna me tarifa më të vogla në të gjithë Kosovën. Ne nga ‘‘Ekoregjioni’’ kemi marrë tjera kërkesa, mirëpo në bashkëbisedim me kryeshefin e ‘‘Ekoregjionit’’ jemi marrë vesh që këto tarifa për komunën tonë t’i zvogëlojmë. Njëra prej arsyeve ka qenë edhe fakti se ne e kemi deponinë tonë, ndërsa komunat tjera nuk e kanë. Kërkesa për amvisëritë ka qenë që të bëhet së paku 7 euro, por ne e kemi bërë në marrëveshje 5.50 euro, këtu hyn edhe TVSh-ja. Nuk do të tatimohen qytetarët shtesë për TVSh-në, por në kuadër të këtij çmimi është edhe TVSh-ja. Gjithashtu, te hapësirat, me metra katrorë, propozimi ka qenë nga 1-20 metra katrorë, ne e kemi bërë nga 1-30 metra katrorë. Këtu e kemi rrit numrin e metrave katrorë. Gjithashtu, nga 1-20 metra katrorë çmimi ka qenë 8.50 euro, ne përveç që i kemi rrit metrat katrorë, e kemi

zvogëlue edhe çmimin, e kemi bërë për një biznes i cili operon në kuadër të këtyre metrave katrorë ta ketë çmimin e pagesës sa një amvisëri. 5.50 e kanë amvisëritë, 5.50 e kanë bizneset individuale që e kanë hapësirën deri në 30 metra katrorë. Pastaj edhe të bizneset me hapësira prej 31-50 çmimi ka qenë tjetër, ne e kemi zvogëluar. Edhe te bizneset me hapësira më të mëdha, mbi 50 metra katrorë, çmimi ka qenë tjetër, ne e kemi zvogëluar. Te kontenierat nuk kemi prek, sepse është çmimi i arsyeshëm. Gjithashtu, edhe të këto hapësirat në shkolla, në institucione, edhe fshirja apo pastrimi i qytetit, larja e qytetit, edhe me Rregulloren e re ka qenë 0.15, që ka qe 10 vite kjo Rregullore. Ne e kemi lënë 0.15, nuk e kemi rrit. Ju nëse doni këtë tarifën e funti me e rrit nga 0.15 në 0.20, siç e propozoi një përfaqësues, na mujm me rrit, nuk është problem. Por nën këtë minimum nuk mund të shkojmë, për arsye se janë çmime shumë të arsyeshme, jemi komuna që i kemi më të ulëta prej gjithë Kosovës. U tha mos me u miratue sot kjo Rregullore, por me u shty, me bo debat. Ne këtë Rregullore po e miratojmë qysh thotë ligji. Ligji e thotë me e formue komisionin, me u hartue Rregullorja, me dalë në bord të drejtorëve, me u debatue, me dalë në diskutim publik një muaj – kjo ka qenë ma shumë se një muaj në diskutim publik – pas diskutimit publik me u mbajt edhe një takim përmbyllës, edhe sot Asambleja me e marrë vendimin përfundimtar. Disa vërejtje u dhanë edhe nga zv/kryesuesi i Asamblesë, i përmendi disa nene. Në të gjitha këto nene janë të caktuara se si bëhet rregullimi i mbledhjes së mbeturinave edhe nëpër ato fshatra ku tash nuk janë të kyçura. Pas miratimi të kësaj Rregulloreje do të bëhet Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Këtë Plan do ta bëjë kompania e licencuar, e cila do të merret me menaxhimin e mbeturinave. Kjo Rregullore parasheh që nëse Komuna e sheh që kjo formë e menaxhimit të mbeturinave e dëmton Komunën, e dëmton interesin e qytetarëve, ne kemi të drejtë këtë me e anulue edhe me u tërheq, edhe me kalue në formën e vjetër të menaxhimit të mbeturinave. Gjithashtu, kjo Rregullore parasheh që Komuna ka të drejtë t’ia japë menaxhimin e mbeturinave një kompanie private, të licencuar, e cila do të merret me menaxhimin e mbeturinave. Kështu që, në këtë formë, kompania e cila është tash, do të thotë ‘‘Ekoregjioni’’, nëse ajo nuk punon mirë, ka mundësi Komuna që t’ia marrë të drejtën edhe t’ia japë dikujt jetër. Ndërrohet kjo Rregullore, shpallet tenderi, thirrja publike. Por, ne nuk jemi të interesuar këtë ta bëjmë, jemi të interesuar që njerëzit tanë që i kemi atje t’i ndihmojmë. Po ashtu, në këtë Rregullore shkruan që Ministria e Financave, në vitin e parë të menaxhimit të kësaj Rregulloreje, duhet ta mbështesë me mjete financiare dhe ta mbështesë me staf, të na rrit numrin e stafit. Ata inkasantë të cilët janë momentalisht të angazhuar në ‘‘Ekoregjion’’, të mos ngelen ata pa punë, por ata të bëhen punëtorë të Komunës, edhe ata të jenë staf administrativ i cili do të merret me përgatitjen e databazës së grumbullimit të mbeturinave. Unë po mendoj që kjo është një Rregullore shumë e mirë, që i menaxhon mbeturinat, edhe te lista A e çmimeve unë ju kisha lut – e di që ju jeni asambleistë dhe ju doni ta mbron interesin e qytetarëve, por interesin e qytetarëve e mbron kjo Rregullore. Çmimet janë

reale, ndoshta janë edhe më të ulëta sesa që duhet me qenë. Gjithashtu, ju e dini që kjo Asamble ka pru një Vendim që në të ardhmen ne të hapim dhe të ndërtojmë dy deponi legale për grumbullimin e mbetjeve inerte apo mbeturinave nga ndërtimet. Ne vendimin nga Qeveria e kemi marrë, ato lokacione që i kemi caktuar Qeveria na i ka dhënë. Për fat të mirë na i ka dhënë pa kompenzim, pa pagesë. Kështu që, ne duhet të gjejmë mjete dhe ato dy deponi t'i ndërtojmë, edhe në të ardhmen edhe deponitë ilegale që janë do të mbyllen dhe të gjitha këto mbeturina që janë të hedhura çdokund nëpër Komunën tonë, do të mblidhen, do të shpallet një tender, do të caktohet një kompani, do ta bëjë mbledhjen e këtyre, pastrimin e ambientit dhe të gjitha do të shkojnë në këto dy deponi. Por, këtu në Rregullore shkruan dy e më shumë, ne kemi të drejtë numrin e këtyre deponive me e rrit. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, kryetar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? z.Samidin Xheladini e ka kërkue fjalën.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Unë kam qenë në një amulli për shkak të situatës, se qytetarët kanë pas vërejtje në lidhje me çmimet, me tatimet, sepse kohëve të fundit disa qytetarë kanë pas një caktim të tarifave shumë të larta. Nuk e di, dokument nuk kam pas para sysh, por deklarimet e tyre, tash sa janë të vërteta nuk e di. Por me këtë Rregullore edhe me sqarimet që i dhanë, una kam qenë me u shty, për shkak edhe se na ka ardhë verzioni me vonesë, dje që na ka ardhë. Edhe prapë po them, hera e fundit le të jetë, ne të gjithë po kërkojmë që dokumenti le të na vjen me kohë, ta analizojmë edhe ta shqyrtojmë. Po ta kishim pas dokumentin me kohë me analizue, ndoshta edhe nuk ishte krijuë ajo amullia. Por tash, mas sqarimeve që i bëtë, unë jam tash për këtë verzion. E pranoj, për arsye se janë inkorporue të gjitha ato shqetësimet që ndoshta na të gjithë i kemi. Ka edhe të tjera ndoshta, po faktikisht nuk u pasqyruan këtu. Por, me verzionin që tash na dhanë sqarim drejtori edhe kryetari, mendoj që janë të mirëseardhura dhe qenkemi ne mirë, e paskemi një përparësi që ne si Komunë paskemi të drejtë operatorit me ia ngreh veshët. Deri më tash nuk kemi pas të drejtë, domethënë me Rregullore s'e kemi pas këtë të drejtë. E di sigurt, se këtë e kam pa, e për atë edhe operatori ndoshta edhe ka pas të drejtë me vendos, se shumë herë neve na ka ardhë – kur ka qenë Salim Jonuzi kryetar – e ka rrit çmimin atje, në Asamble nuk na ka pru fare hiç. Nuk na kanë pyet hiç, nuk kanë pas ata kurrfarë përgjegjësie me rrit ose me menaxhue çmimin, e kanë bërë në mënyrë të pavarur, për çmimet edhe për tarifatat edhe për krejt gjërat. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, z.Xheladini! Sejdilar e ka kërkue fjalën. Një minutë, të lutem, se po e përfundojmë më këtë pjesë.

Nedžmidin Sejdilar: Samidini e tërhoqi propozimin e tij për shtyrjen e kësaj pike dhe ju njoftoj se nuk po e tërheq propozimin tim. Në parim, versionin e fundit të këtij rregulloreje e kemi marrë dje pas orarit të punës. Nuk u përgatita sa duhet për këtë çështje. Së dyti, këtu u përmendën disa çështje

që ne nuk mund t'i zgjidhim ad-hoc tani. Siç tha edhe Jonuzi, duhet një debat publik ku do të jenë të pranishëm qytetarët dhe jo si debati i fundit publik ku në këtë sallë ishte vetëm drejtori dhe askush tjetër. Ju jeni në dijeni të faktit se në atë debat nuk mori pjesë asnjë përfaqësues i fshatit dhe as një qytetar i vetëm. Është faji ynë dhe faji juaj si kreu i pushtetit ekzekutiv që nuk mund të sjellë njerëz në debate publike për mungesë transparence dhe për faktin se datat e debateve publike nuk shpallen në mënyrë të mirë civilizuar dhe të qasshme për qytetarët. Lidhur me këtë, unë ende propozoj që ky rregullorë të shtyhet për seancën e radhës dhe para kësaj të organizohet një debat publik me përfaqësuesit e komiteteve të fshatrave dhe në bazë të atyre procesverbaleve të përgatitet siç duhet ky rregullorë dhe në . në të njëjtën kohë përfshihen edhe këto propozime nga përfaqësuesit e qytetarëve nga ky Kuvend.

Uran Halimi: Një minutë replikë, z.Xheladini.

Samidin Xheladini: Pikërisht, z.Nedžmidin. Edhe parëz fola për papërgjegjësinë. Përfaqësuesit e fshatrave – ka qenë diskutimi publik – pse nuk kanë marrë pjesë. Kanë marrë përgjegjësi edhe nuk kanë marrë pjesë në debat publik. I obligon ligji, ata janë të paraparë për me marrë pjesë në diskutim publik, edhe nuk po e kryjnë punën qysh duhet. Ka qenë ti thaje veç drejtori, e paske informatën e saktë, unë s'e kam ditë. Na s'e kemi ditë që veç drejtori paska marrë pjesë në diskutim publik. Kjo është papërgjegjësi totale. Edhe ne si Asamble kemi ra prej provimit, se edhe ne duhet të marrim pjesë në atë diskutim edhe ta japim kontributin tonë. Unë asnjëherë s'kam marrë pjesë, se s'kam qenë ndoshta edhe i interesuar ose i informuar. Papërgjegjësi totale, që në fillim e ceka, papërgjegjësi. E paskan mbajti diskutimin publik, po më vjen keq por këta e paskan krye obligimin ligjor. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit! Munir Jonuzi e ka fjalën.

Munir Jonuzi: Kur mbajta fjalën time të hyrese, fola për strukturën e popullsisë sonë. Struktura e popullatës sonë që ka mbetur këtu në këtë komunë është e vjetër, kështu që ata nuk ndjekin mjaftueshëm rrjetet sociale dhe sigurisht që nuk e dinin që në datën 02.10 kemi një takim publik. Ne organizuam këshillat e fshatrave. Ne, e kemi për detyrë t'i ftojme sa herë që bëhet diçka në favor të tyre ose kur bëhet fjalë për diçka kur ky kuvend duhet të marrë një vendim. Nesër kur dikush nga fshati më pyet mua apo kryetarin, ata që nuk janë në sistem, se çfarë i detyrohem kësaj komune, 5,5, 6,5 12 euro, mbi çfarë baze, se kuvendi ka votuar kështu. Me pas do na kapin ne qafe dhe do thone si keni votuar pa dijeninë ne. Këtu duhet të jemi përgjegjës. Unë nuk jam kundër këtij rregullorë dhe është me vend që pas 10 vitesh pas miratimit të ligjit për mbeturinat të kemi një rregullorë. Nuk do të flas për çmimin. Ju e dini se gjithçka është bërë më e shtrenjtë dhe asgjësimi i mbeturinave gjithashtu mund të bëhet më i shtrenjtë. Kjo nuk duhet të jetë shumë problem. Problemi është nëse

do ta respektojmë këtë Rregullore që po votojmë. Një sistem derë më derë është jopraktik. Mund të jetë e realizueshme për Prizrenin, për disa komuna të tjera, por në komunën tonë nuk është e realizueshme. Nëse këtu votojmë derë më derë, secili prej nesh do të kërkojë që plehurat t'i merren nga dera e hyrjes. Unë fola për disa përfitime që ne si komunë duhet t'u japim qytetarëve tanë, për t'u siguruar atyre një hapësirë ku ata të grumbullojnë mbeturinat në mënyrë më cilësore. Çfarë do të bëjmë dhe si do t'ua shpjegojmë këtyre fshatrave që nuk janë në sistem. Ne morëm një vendim, nuk u konsultuam me ta dhe ata duhet të paguajnë për këtë. Nuk ka të keqe ta vonohet kjo Rregullore. Ne do ta miratojmë këtë rregullore, nëse jo sot, pas një ose dy muajsh. Është e rëndësishme që ky rregullore ka arritur në Kuvend. Nuk besoj që ndonjë nga delegatët të jetë kundër kësaj rregulloreje. Ne jemi këtu për të bërë ndryshime. Kam folur për mbeturinat e ngurta, por askush nuk më është përgjigjur. Kërkova një amendament për bartjen e mbeturinave të ngurta dy herë në vit. Dhe se duhet të përcaktohet me kohë. Javën e parë të majit, javën e fundit të korrikut. Kur përqendrimi i popullsisë është më i lartë. Kjo nuk është arsye që ne nën detyrim ta miratojmë këtë.

Uran Halimi: I fundit që ka me e pas fjalën është kryetari, e përmbyllim këtë diskutim.

Bexhet Xheladini: Për mbeturinat voluminoze, ormana, dysheka, jasteka, e këto të amvisërisë që janë, që gjuhen, aty shkruan më shumë se një herë. Kur të shkruajë më shumë se një herë, munden edhe pesë herë me u organizue, nuk është problem. Mu ma merr mendja që, nëse ne organizojmë një herë në vit, shpallim një tender, është e mjaftueshme. Atë do ta bëjmë kur të vijmë këta të botës së jashtme. E shpallim tenderin edhe një herë në vit i mbledhim. Por, nëse e shohim të arsyeshme që ka nevojë dy herë në vit, tri herë, na e bëjmë edhe dy herë, se Rregullorja na lejon. Por nëse na e lëmë në Rregullore dy herë në vit, na duhet patjetër dy herë në vjet me e organizue mbledhjen e tyre, edhe ndoshta s'ka nevojë. Këtu është problemi. Kur të thuhet më shumë se një herë, atëherë ajo nënkuptohet. Sa i përket miratimit të kësaj Rregulloreje, është në dorën tuaj. Ju jeni përfaqësues të popullit edhe ju i përfaqësoni secili nga një pjesë të votuesve tuaj edhe të popullatës. Nuk është e thënë që për çdo gjë ju duhet të dilni ta pyesni popullin, sepse juve ata ju kanë zgjedhë, ata juve jua kanë dhënë votën. Po nëse ju vendosni që me e shty, me i thirrë qytetarët me debatue, atëherë – ne si pushtet lokal e kemi zbatue me përpikmëri ligjin si miratohet një rregullore, i kemi ndjek të gjitha procedurat – masi ju doni me bo punë shtesë, atëherë kur ta qet në votim kryesuesi i Asamblesë propozimin e juaj me e shty, atëherë duhet të caktohet edhe kush ka me e marrë përsipër me i thirrë qytetarët, me ardhë ata këtu në mbledhje, me debatue me ta. Pastaj të vihet edhe një kohë e caktuar që kjo të bëhet deri në Asamblenë e ardhshme. Ka mundësi ne Asamblenë e ardhshme e thirim brenda 15 ditëve, ka mundësi që e thirim këtë muaj. Kështu që, bëjeni planin mirë, qitni të dy propozimet, kush është me e shty e kush është me e miratue me qeto ndryshimet që i lexoi drejtori. Unë jam përgjegjësi kryesor i kësaj Rregulloreje,

të gjitha punë të cilat do të bëhen pastaj, përgjegjës është kryetari. Edhe për hartimin i Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave, debatin edhe iniciativën e merr kryetari. Çfarë vendimi të merrni ju – nëse jemi vonue edhe nëse vonohemi edhe pak nuk është problem – e keni të drejtën e juaj me e marrë një vendim. Por, nëse e merrni vendimin me e shty, ju si Asamble duhet me e marrë përsipër me i thirrë qytetarët me ardhë në debat publik. Falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, kryetar! Kemi shumë propozime sa i përket kësaj pike të rendit të ditës. Nëse e shtyjme, mirë e tha kryetari, atëherë duhet na si Asamble me u aktivizue, me marrë pjesë në debat publik, me i ftue edhe këshillat e fshatrave edhe me e plotësue në mënyrën më të mirë të mundshme këtë Rregullore. Nëse jeni dakord që mundeni me e bo një diçka të ngjashme – ma herët u ankuan që s’po vini në seancë me rregull. Unë duhet me i qit krejt propozimet në votim. Jo, u krye mo Nedžmidin. Jo, unë propozimet me rend kam me i qit, qysh i kanë bo ashtu edhe kam me i qit, edhe çka të vendosni ju është në rregull. Domethënë, po vazhdojmë me propozimet. Njëri prej propozimeve në fillim ishte i Dritonit. Okej, atëherë po e hedhim në votim propozimin e z.Munir Jonuzi edhe kushdoqoftë tjetër, që ka bo propozim për me e shty. A e ke bo qet propozim? Po këtë po e qesim në votim, se nëse shtyhet, këto krejt propozimet tjera bien poshtë. Të nderum delegatë, po ia jap 20 sekonda Nedžmidinit, një sqarim, se është t’u insistue. Po kërkoj mirëkuptim.

Nedžmidin Sejdlar: Nuk shoh problem në organizimin e përfaqësuesve të komiteteve të fshatrave, për t’i sjellë në sallën e kuvendit për të marrë pjesë në hartimin e këtij rregulloreje. Komuna si institucion i ka të gjitha kontaktet e tyre, ka formuar një komision që i ka certifikuar. Kemi kontakte të përfaqësuesve të fshatrave. Thjesht duhet t’i telefonojmë dhe të caktojmë një takim dhe të dërgojmë një shofer për t’i marrë nëse është e nevojshme.

Uran Halimi: Falemnderit shumë, z.Sejdlar! Unë e di që kjo është në të mirë të qytetarëve, mirëpo edhe qytetari duhet me qenë shumë më aktiv për çështje kur ka të bëjë direkt me interesin e qytetarëve. Këtë Rregullore, jam i sigurt që edhe nëse e shtyjme, prapë e njëjta ka me u bo, edhe i njëjti debat. Sidoqoftë, është në dorën e juaj, të nderum delegatë, a e shtyni apo jo. Po e hedhim në votim. Po besoj që edhe këto propozimet që janë bo janë propozime shumë të mira. Nëse kalon me ndryshime është perfekt. Domethënë të parën na po e qesim a kalon a jo, këtu është problemi a me e shty a jo. Këtu është problemi që propozimet janë shumë të mira. Nëse na e shtyjme këtë pikë të rendit të ditës, i bjer që ndryshimet bien poshtë. Tarifa nuk ulet, mandej i kemi familjet e dëshmorëve që nuk përfitojnë, invalidët e luftës edhe veteranët. Domethënë, nëse e shtyjme edhe e hedhim poshtë, kemi me e hedhë poshtë me krejt propozimet që janë shumë të mira. Sidoqoftë, po e hedhim në votim. Hajde, Muniri ta shohim çka po na thotë.

Munir Jonuzi: Nëse e shtyjme këtë rregullore, nuk do të thotë se shtyhen edhe këto propozime. Ata

qëndrojnë atje. Thjesht duam t'i klasifikojmë në atë rregullore. Ju po përpiqeni të votoni secilin prej këtyre propozimeve veç e veç. Kjo nuk është e drejtë. Ne kemi një rregullore, kemi propozime, mund të bëni pyetjen, kush është për miratimin e rregullores me amendamente të miratuara nga kryetari, sepse ka disa amendamente që kryetari nuk i ka miratuar.

Uran Halimi: Duhet me e pas parasysh se kryetari tha që nën këto çmime e kemi problem me shkue. Domethënë, çmimet që janë paraqit në tabelë janë çmimet minimale të mundshme. Këtu është esenca që po thotë z.Jonuzi. Sidoqoftë, po e hedhim në votim nëse është për me u shty ose jo. Tash ndryshimet mos me ra poshtë, kur të vjen me një seancë tjetër vijnë edhe 20 ndryshime tjera. Hajde, Hajredini! Një sekond veç!

Shpetim Hajredini: Nëse nuk iu pengon kolegëve edhe ekzekutivit, gjithashtu edhe juve kryesues, a ka mundësi pesë minuta t'i marrim pauzë, të koordinohemi pak, të diskutojmë pak ma njerëzisht edhe po e marrim pastaj vendimin, dona me e shty, nuk dona me e shty ose cilat propozime po i votojmë. Nëse është e mundshme, se realisht nuk i kemi prit këto debate, këto ndryshime, edhe nuk jemi përgatit se çka ndodh. Nëse është e mundur, po i marrim pesë minuta, jo ma tepër.

Uran Halimi: I nderum delegat, unë s'e kam problemin për pauzë, por mundësisht, nëse i lypim pesë, po i mbajmë pesë minuta pauzë. S'kemi nevojë me dalë jashtë, vetëm mediat mundin me e ndërpre transmetimin për pesë minuta, edhe rikthehemi edhe vazhdojmë. Atëherë i kemi pesë minuta pauzë. Ju lutem mediat që me e ndërpre transmetimin!

Të nderum delegatë, ju ftoj të uleni në vendet tuaja, në mënyrë që të vazhdojmë me seancën. Po vazhdojmë aty ku e lamë. Sipas rregullit, na duhet ta hedhim në votim së pari këtë Rregulloren qashtu qysh na ka ardhë, pa ndryshime. Pastaj vazhdojmë me procedurat e radhës. Duhet të votojmë kush është pro Rregullores pa ndryshime, kështu qysh na është servue nga ekzekutivi. Domethënë, me propozimet e drejtorit, po thotë kryetari. Mandej i kqyrim procedurat, nëse votohet. Atëherë kush është pro kësaj Rregullores, qysh na është servu nga ekzekutivi? Kush është kundër kësaj Rregullores, qysh na është servu nga ekzekutivi? Abstenim? Nuk ka. Tash i kemi 11 vota pro, 12 vota kundër. Domethënë, qysh është servu, kjo Rregullore nuk ka kalu. Tash vazhdojmë me propozimet. Të nderum delegatë, ju lutem! Votat u numëruan. Nuk është që s'i kam numëruë mirë, ke hup kryetar, se i ke pas 11 vota, këndeje kanë qenë 12 vota. Tash erdh ky, mas votimit. Sidoqoftë, janë 11 vota pro, 12 vota janë kundër. Tash duhet me e qit na në votim me ndryshime. Ose, propozimet një nga një, qysh i kemi bo. Tash janë shumë propozime këtu. Bashkë krejt nuk bon, se krejt në fund është propozimi për me e hek krejt, po, për me e shty për një seancë të radhës. Nuk e kemi shty, janë propozimet tash. Jo bre, s'ban, ngom mu qetash edhe duro! Janë propozimet o burrë qetash. S'kaloi pa ndryshime, kemi me i

qit propozimet në votim. Nuk ka vdek hala, ka shpirt, varet na a dojmë me mbajt në jetë a me e lonë në gjendje kome. Tash i kemi propozimet nga një nga një dhe kemi me i qit në votim krejt me rend, qysh i kemi bo secili. Propozimi i parë është i Driton Ademit, i cili i ka ulë tarifafat, i ka rrit metrat këtu. E dini qysh janë edhe i kemi të shënume, mos t'i përmendi edhe një herë. Plus çmimin e fundit e ka rrit prej 0.15 euro, pastrimin e qytetit, e ka bo 0.20 euro. Domethënë, shumicën i ka ulë, i ka ngrit metrat, ndërsa te e fundit, e kemi tarifën për pastrimin e qytetit, e ka bo nga 0.15 euro për metër katror, në 0.20 euro për metër katror. Ose, po më thotë Ademi që me i lexue unë këto. Domethënë, komplet propozimi i z.Driton Ademi ka qenë që bizneset me hapësirë prej 1-30, siç ishte më parë, me e bo prej 1-50 metra katrorë, edhe çmimi ka me qenë 5.50 euro. Tjetra, ndryshimi i dytë, ka thënë që bizneset me hapësirë prej 50, me u bo deri në 100 metra katrorë, prej 51-100 me çmim 8 euro, prej 10 në 8 euro. Edhe propozimi tjetër ka qenë që bizneset me hapësira mbi 101 metra katrorë me qenë çmimi prej 15 në 12 euro. Mandej e ka bo tarifa minimale për institucionet publike, domethënë te kontenierat është në pyetje, ka bo që kostoja e kontenierit për 1 metër kub me qenë nga 13 euro në 10 euro. Kostoja e kontenierit me 7 metër kub, nga 50 euro në 40 euro. Te tarifa minimale për shkolla, e ka ulë për metër katror, nga 0.15 euro në 0.12 euro. Te tarifa për institucionet tjera, zyra, lokale, stacionet policore, e ka ulë nga 0.15 euro në 0.12 euro. Ndërsa, tarifafat minimale për pastrimin e qytetit, sipas metrit katror, e ka bo nga 0.15 euro metri katror, e ka rrit çmimin në 0.20 euro. Domethënë, vetëm të puna e pastrimit të qytetit kemi ngritje të tarifave.

Munir Jonuzi: Ndoshta do të ishte më logjike që ju të vendosni propozimin tim për shtyrjen e kësaj Rrregullore për ndonjë asamble të mëvonshme, në vend që të shqyrtoni atë që propozoi Dritoni. Le të shkojë së pari propozimi im dhe më pas propozimi i Dritonit për votim.

Uran Halimi: I nderum z.Jonuzi, ta shohin qytetarët një herë qysh po i votojmë propozimet. Hajde, ju lutem! z.Samidini s'pyetën a me dalë, veç del këtu. Kurrë mos pyet, hajde vazhdo!

Samidin Xheladini: Dola, s'të pyes hiç. Ngjihi votat mirë! Pse po na bëjsh budallë para sysh? Ngjihi votat mirë, të lutem!

Uran Halimi: Ju lutem, votat janë numërue shumë mirë. I nderum Xheladini, votat janë numërue shumë mirë. Po Kuvendi është i jemi, se unë jam shef i Kuvendit. Pse, a unë po dësh me t'i bo numrat ty a?

Sidoqoftë, po rikthehemi. Është komplikue situata. S'e kam bo me qëllim Samidin, se të njeva. Je shumë gabim. T'i dhashë pesë minuta kohë, kërkova me iu përmbajt kohës, i bëmë 15 minuta ose ma shumë, edhe çka kam me bo unë qetash. Ju thirra me u ulë në vendet e juaja, ku e di unë kënd me e prit e kënd jo tash. A me e prit edhe Xhemilen që mungon? A ta pres edhe Jetmirin që s'është këtu? Okej, kemi me i prit. Xhemilja që ke prej sabahit, a duhet me e prit? Pse, s'po të konvenon me e prit,

a po? S' duhet me e prit, se ajo ka shkue për mos me u kthye qetash, çka me e prit? Kemi kuorum për me vazhdue seancën. Procesi u komplikue. Votimi që u bë nuk zhbëhet. Këtë e keni të sigurt. Tash varet qysh ne dëshirojmë, na mundim me e qit propozimin e Munirit për me e përmbyllë krejt, ose me vazhdue me propozimet. Numrat i keni qetash, votoni kundër propozimeve, lëne qeshtu qysh po doni ju. E patëm propozimin e Driton Ademit. Kush është pro propozimit të Driton Ademit? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 12 vota pro, 9 kundër edhe 3 abstenime, kalon propozimi i z. Driton Ademi. E kemi propozimin e dytë, propozimin e z. Shpetim Hajredini, i cili ka kërkuë që familjet e dëshmorëve, invalidët e luftës dhe veteranët të lirohen nga pagesa e mbeturinave. Kush është pro këtij propozimi që veteranët e luftës, invalidët e luftës dhe familjet e dëshmorëve me u lirue nga pagesa? Kush është kundër këtij propozimi? Abstenim? Atëherë i kemi 12 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim për propozimin e z. Shpetim Hajredini. Ka kalue. Po s'po të votojnë, prezentë janë plotë... 13 i kie ti në pozitë, 25 janë total. Po ka kalue, se s'ka kundër, o kryetar. Edhe krejt në fund e kemi propozimin e z. Jonuzi, i cili ka thënë që kjo Rregullore të shtyhet në një seancë të ardhshme. Qeshtu janë propozimet me rend, çka kam me bo unë. Tash ka thënë z. Jonuzi që kjo Rregullore prej fillimit me ndodhë, me fillue dëgjimet publike edhe me u ndryshue. Kush është pro propozimit të z. Jonuzi që kjo Rregullore të rifillojë nga e para edhe të vjen në Kuvend në seancat e radhës? Propozimet bien poshtë, Rregullorja vjen nga e para, kurdo që vjen. Kush është pro propozimit të z. Munir Jonuzi? Kush është kundër propozimit të z. Jonuzi? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 16 vota pro, me 1 kundër edhe me 9 abstenime, kjo Rregullore duhet të ripërsëritet në seancat e radhës. Jo, s'po e marrim fjalën, po po shkojmë në pauzë edhe kthehem në ora 14:00. Ju falemnderit shumë!

Samidin Xheladini: Deleгатë, veç një minutë! Pikërisht kryesuesi ka qenë dashtë me e qit në votim qet pikë, mos me u bo na këtu me votue kundër njëri-tjetrit.

Uran Halimi: Deleгатë të nderum, po vazhdojmë, po rikthehem për vazhdimin e seancës aty ku e lamë. Kemi mbet te pika e katërt, me sa e di unë. E kemi Raportin 9-mujor Financiar për vitin 2023. A është në lidhje me pikën e katërt, apo jo? Po te eventualja atë mundesh me e bo. Okej.

Edin Kurt: Falemnderit zoti kryesues. Nuk ka të bëjë me pikën e katërt dhe nuk ka të bëjë me pikën eventuale, ka të bëjë me pikën e mëparshme. Pak më parë kur votuam pikën e mëparshme, u vonuam pak, kishim disa konsultime se si do të votojmë. Kur arritëm në vendet, z. Samidin Xheladini fjalë për fjalë na kërcënoi. Mua dhe koleges Ventaza. Pse jemi vonuar, ku jemi deri tani, si duhet të votojmë, a paguhemi për të etj. Zoti Xheladini, unë nuk jam punonjësi juaj. Ju nuk më paguani. Këtu nuk jam pranuar me konkurs. Unë jam delegat në këtë kuvend. Është vullneti im nëse do votoj, si do votoj, do vij apo jo. Eshte kjo ne rregull? Pikërisht për këtë po flas. Ju lutemi mos lejoni që gjëra të tilla të përsëriten. Ju ngritët zërin ndaj meje dhe kolegës time. Ka dëshmitarë për këtë. Kërkoj që

gjëra të tilla të mos ndodhin. I kërkoj kryesuesit dhe nën kryesuesit të reagojnë, të sanksionojnë zotërinë. Unë nuk jam punonjës i askujt. Do të votoj ashtu siç dakordohem unë dhe partia ime. Dhe nëse mungoj në seancë, prandaj më hiqet medijtje, apo jo? Kjo është e drejta ime. Ai nuk mund të më thotë se si dhe çfarë do të bëj.

Uran Halimi: Falemnderit, z.Kurt! Çka me të thënë, ke të drejtë me ardhë, mos me ardhë, me u vonue, mos me votue. Është e drejtë e jotja. Ishalla s'përsëritet! Munir Jonuzi e kërkoi fjalën. Jemi të Raporti 9-mujor, po hala s'po më lënë me hi, në prag jemi. Muniri ka të drejtë, se është zv/kryesues, tash ju mos i qyrni shumë hollë sendet. I nderum delegat, veç pak ta dëgjojmë z.Jonuzi.

Munir Jonuzi: Falemnderit z.Kurt që na u drejtua kështu. Është e vërtetë që askush nuk mund të përcaktojë asgjë për ju. Ju jeni këtu me vullnetin e popullit, votuesit tuaj, si të gjithë qytetarët, presin që ju të votoni ashtu siç mendoni se është e drejtë për ta dhe të jeni në shërbim të tyre. Në lidhje me termin që keni përdorur do të kërkoja të na kontaktoni me shkrim që të shohim se çfarë mund të bëjmë ne, dhe unë ne rolin e zv.kryesuesit të kuvendit. Sepse edhe unë jam përgjegjës për ju. Zoti Xheladini, kjo është hera e dytë që ju nuk u jepni të drejtë delegatëve të komunitetit joshumicë të flasin, të shprehin lirisht mendimin e tyre. Nuk do ta besoj se këto ishin kërcënime, sepse është një fjalë shumë e rrënd. Por nëse zoti Kurt thotë kështu, ne mund ta marrim fjalën tuaj kundër tij si fillim. Z. Kurt ju lutem na drejtoheni, ne do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për të zgjidhur këtë problem.

Uran Halimi: Falemnderit për parafolësit! Këto janë procedura që s'kanë të bëjnë me pikën për të cilën po flasim. S'pat diçka zyrtare edhe serioze, ta shujmë këtë muhabet, këtë debat. Të drejtën për me e dhënë fjalën unë e kam edhe s'mundeni me e mohue. Unë nuk besoj që dikush është kërcënue këtu, e iu mohue e drejta e fjalës, se unë jam ai që ia jap të drejtën me folë kujtdo që ka nevojë. Veç çojeni dorën, unë s'ia kam mohue kërkuj fjalën. Domethënë, Xheladini s'e ka fuqinë për me ia mohue as Kurtit të drejtën e fjalës, e asnjërit prej delegatëve, si prej atyre shumicë, si prej atyre joshumicë. Ajo tendenca për me e viktimizue veten mu s'më pëlqen edhe nuk është në rregull. S'ka kurgjo këtu tendencioze, po besoj, nga ana e z.Xheladini. Është një polemikë kështu private, që secili na mundim me e bo me secilin. Kështu që, është mirë mos me i ekzagjerue gjërat. Nja dy minuta po ia japim edhe z.Xheladini edhe po vazhdojmë me pikën e radhës.

Samidin Xheladini: Mu po më vjen keq prej zv/kryesuesit, që pa ditë, pa argumente, bëhet gjykatës. Ti s'je konë dëshmitar edhe fjalët s'i ke dëgjue. Ku e dish ti? Pse po i besojsh atij? Ndoshta s'është qashtu hiç. Ti po dëshmon rrejshëm, po dëshmon pa argumente edhe po më akuzon publikisht këtu, edhe po bazohesh në minoritetet. Domethënë një akuze që të shkon ty të parit në qafë. Se shpifja shkon e sillet e të vjen ty. Ti je falë me mu, namaz ke falë qetash edhe duhet me iu tut Qatij që i ke ra në

sexhde. Domethënë, ti, me paragjykime, po çohesh po flasish këtu publikisht, të ndien opiniononi edhe besojnë që është qashtu. Sa për sqarim, votimi ka qenë – krejt jemi konë prezent edhe janë video incizimet – në moment kur është bo votimi, mu më ka pyet kolega im, Mehmet Spahiu, se është ma i vjetër edhe m’u drejtue mu, tha qysh bëhet. Unë atëherë jam kthye mbrapa, i kam pa që janë prezent këta tjerët. I kam ngjeh votat, i jam drejtue kryesuesit – po de, votat e koalicionit i kam ngjeh, edhe më dolën që 13 veta janë prezent – edhe t’u drejtova ty, thashë s’i ke ngjeh mirë votat. Kur thaje jo, këta s’janë konë prezent, atëherë unë thashë që e ke bo me qëllim që mos të kalojë. E ke pa që s’janë prezent, e ke qit në votim, s’i ke prit personat në fjalë. Edhe unë u jam drejtue atyre mbrapa, iu kam thënë ku jeni konë, ata e dinë se çka kanë thënë, le ta mbajnë në mend, se po e dikan mirë çka iu kam thënë. Le ta dëshmojnë atë, unë e jap atë argumentin tem. I kam thënë atij zotërisë në fjalë – tha unë s’jam konë këtu – i thashë ti duhet me konë këtu prezent se paguhesh, marrish rrogë. Është e vërtetë, është e vërtetë. Për të gjithë vlen, edhe për mu vlen. Për të gjithë vlen, ne e kemi përgjegjësi me qenë prezent edhe me votu qysh të doni, nuk ka qenë fjala e votimit fare. As kam diskutue, unë s’e kam ditë as çka kanë votue. Unë kam mendue se kanë votue pro, ata as nuk ishin konë prezent. Qetu shihet që kjo është shpifje e kulluar. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit! U kry diskutimi për këtë pikë. E kemi pikën eventuale, mundeni me e shfrytëzue kohën edhe aty. Po vazhdojmë me pikën e katërt, është Raporti 9-mujor Financiar për vitin 2023. Nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Fjalën e ka kërkue z.Nedžmidin Sejdlar.

Nedžmidin Sejdlar: Pershendetje. Unë kam disa vërejtje lidhur me këtë raport. Do të filloj me pikën 13130 shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, tabela nr.4, tatimpaguesit kanë të drejtë të dinë se ku i shpenzojnë paratë e tyre. Në vitin 13130 shpenzimet e udhëtimit në vend, në vitin 2022 komuna ka shpenzuar 11.472 euro, ndërsa në vitin 2023 ka shpenzuar 30.513, më shumë për 265,98%, ndaj më intereson se ku keni udhëtuar shumë në vend dhe ku janë rezultatet e atyre udhëtimeve. janë. Çfarë ka përfotuar komuna jonë nga kjo? Kodi 13141 Shpenzime të vogla, para xhepi, këtu me rritje 980%. Vitin e kaluar janë shpenzuar 764 euro, këtë vit 7154 euro. Kujt i kemi mbushur xhepat nga buxheti. Për 13330 shpenzimet postare janë rritur nga 3247 në 11609 euro. Këto kosto nuk do të ishin të konsiderueshme nëse nuk do të kishim shpenzimet e pagesës e internetit, i cili gjithashtu u rrit, si dhe kostot e telefonit dhe komunikimit. Që do të thotë se keni dërguar letra dhe pako për 11609 euro. Duke marrë parasysh që një dërges në Kosovë kushton 2 euro, do të thotë se keni dërguar 5805 letra. Kështu që unë jam i habitur dhe pyes veten nëse keni punësuar dikë që të lëpijë zarfet tuaja. Këto zarfe duhet të paketohen. Më pas, 40 mijë e 639 euro të shpenzuara për karburant automjetesh. Kur e ndajmë të gjithë këtë me çmimin mesatar prej 1.40 për litër, rezulton se komuna e Dragashit ka

udhëtuar 295,000 km për 9 muaj, që do të thotë se komuna ka qenë në Prishtinë 1,200 herë. Nëse hekim të shtunën dhe të dielën, kjo do të thotë se stafi juaj ende vozitë. Kjo do të thotë që disa lëpijnë zarfet dhe të tjerë ngasin vetura. Keni 6926 euro për materiale higjienike dhe ska letër higjienike. As në Qendrën Shëndetësore nuk ka materiale higjienike. Si arrini të vozitni kaq shumë, të ngjitni zarfe dhe të qëndroni në tualet. Kostot e informacionit publik u rritën me 161%. 2022-4787 euro, këtë vit 7708 euro. Kërkoj që të më shpjegoni këto kosto. Shërbimet e kontraktuara 117,239 euro në vitin 2023, që është 249% më shumë se vitin e kaluar. Më intereson se çfarë shërbimesh janë kontraktuar apo ku kanë shkuar gjithë ato para. Kodi 13509 pajisje tjera vitin e kaluar kemi shpenzuar 3717 euro sivjet deri ne shtator 27500.39 euro. Që sipas llogaritjeve tuaja është një rritje prej 740%. Çka është pajisje të tjera, duke pasur parasysh që kur vizitohet zyrat e komunës, zyrat tuaja duken si shpajz. Tavolinat janë të periudhës së komunizmit, ku i kemi shpenzuar ato mjete. Përfitues të subvencioneve, ju subvencionuat organizatën joqeveritare QSGF P, më intereson se cila organizatë është dhe çfarë bën. Rinia Demokratike e Gore është dy herë në listë. Një herë me 3000 euro dhe herën e dytë me 2000 euro. Në bazë të cilit ligj ua keni dhënë ato para, kur u refuzuan në gjashtë muajt e parë të këtij viti. Për këtë ekziston një shënim në faqen e internetit të komunës. Kur aplikuan për festën e goranëve, u refuzuan, sepse nuk i plotësonin kushtet. Pas kësaj, në të njëjtin gjashtë muaj na erdhi raporti se i keni subvencionuar me 2000 euro. Kur dikush refuzohet në konkurs, ne kemi ankesa, kemi procesverbal ose nëse tashmë është i subvencionuar, atëherë bëhet përmes Komisionit për Politikë dhe Financa, dhe unë nuk kam informacion të tillë nga kolegët e mi që kanë miratuar 2000 euro për këtë organizatë joqeveritare. Më intereson se ku i ka shpenzuar Rinia Demokratike Gore këto 2000 euro, pastaj 3000 euro, më intereson OJQ-ja Mbështetje për Gratë, SENSEA, ku ka shpenzuar 4000 euro. Kam kërkuar të paktën pesë herë raport financiar për këtë organizatë joqeveritare dhe për atë projekt, sepse më interesojnë detajet se ku janë shpenzuar ato para. Nuk do të flas për keqpërdorimin e parave nga kjo organizatë joqeveritare. Më duhej të insistoja që kjo organizatë të paguajë personat që morën pjesë në këtë kuazi projekt. Edhe pas marrjes së parave, kjo organizatë nuk i paguante njerëzit siç duhet. Organizata joqeveritare Emkaç band, çfarë kanë bërë? A është kjo organizatë joqeveritare e njëjtë që kur e refuzuan kryetarin e komunës, i dhanë mikrofon për të folur. Në rrjetet sociale ka pasur njoftime të ndryshme për shtyp. Kishte një deklaratë se kjo organizatë joqeveritare përvetësoi ngjarjet familjare, duke e paraqitur atë si financim nga komuna. Konkretisht më intereson se ku i kanë shpenzuar këto para. Unë pyes se kur do të kem mundësi të shoh raportet e tyre financiare unë si përfaqësues i popullit, si delegat. Këto sende nuk kanë asgjë për mua këtu. Më intereson konkretisht se ku është shpenzuar çdo cent i qytetarëve. Investimet kapitale, furnizimi me ujë, ndërtimi i ujës-jellësit kryesor në Dragash janë shpenzuar 137,000 euro. Këtu thuhet se keni shpenzuar këtë shumë parash. Nuk kam parë asnjë punë. Do të pres raportin përfundimtar në

mars dhe më pas do të flas. Unë ende insistoj që të më jepni përgjigje të arsyetuara dhe të detajuara për këto pyetje, më intereson më së shumti nëse keni shpallur konkurs që dikush t'ju ngjitë pulla postare.

Uran Halimi: Falemnderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën në lidhje me pikën e parafundit? Për ata që s'e marrin fjalën, nuk kanë të drejtë me bo replika mandej. Okej, drejtori e ka fjalën.

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Përshëndetje kryetar, kryesues, zv/kryesues! Të nderuar delegatë! Pas një mbledhje kështu maratonike, ku pak a shumë keni pas probleme, ma merr mendja që kur është çështja te paret, duhet pak me kesh, pak m'u konë ma atraktiv, për arsye se paret janë send i mirë edhe mund të diskutojmë shumë shtruar. Falemnderit shumë për të gjitha pyetjet, Nexho, edhe po më vjen mirë që e ke një guxim prej delegatëve që t'i parashtrorsh çështjet që të debatohen. Shpenzimi i parave që, pak a shumë në mënyrë atraktive edhe shumë në mënyrë të lezetshme, kështu në mënyrë artistike e elaborove, po të tregoj që është tepër i thjeshtë, se shifrat nuk lënë me rrejt. Është transporti i nxënësve që reflekton në udhëtimet e brendshme dhe paguhet nga ky pozicion. I nderuar delegat, ke të drejtë se Drejtoria e Financave i ndan paret. Ju jeni organ më i lartë edhe na çdo veprim e kemi bo në bazë të vendimeve të juaja. Ju e dini se keni pas një vizitë studimore dhe nga ajo vizitë studimore janë pagu edhe mëditjet nga 26 euro që janë marrë. Janë paratë e xhepit të cilat janë pague për ju. Shpenzimet e transportit, 40,639.32 euro. I nderuar delegat, shumë konkret jam, duhet të më përcjellësh, shpenzimet e transportit hyjnë edhe të gjitha shpenzimet që janë bërë për hapjen e rrugëve, që kemi një memorandum bashkëpunimi me KFOR-in Turk. Në qoftë se ke nevojë për informata detale, mund të vijsh në zyrë, për secilën faturë veç e veç jam në gjendje me të informue, deri sa kanë qenë shpenzimet për hapjen e këtyre rrugëve. Sa i përket informimit publik, ju e dini se për herë të parë Komuna e Dragashit ka marrë pjesë edhe në panair. Përpos shpenzimeve publike të cilat janë bërë përmes mjeteve të informimit që janë pague, janë pague edhe disa fletëpaluese të cilat janë shpërndarë në panairin e parë. Tash përsëri jemi në panairin e dytë, më 19 dhe 20 tetor, ku e kemi përfaqësue Komunën edhe nga katër biznese. Tash është rundi i dytë që do të marrim pjesë në këtë panair dhe gjithashtu këto kanë krijue shpenzime dhe duhet të paguhet nga ky pozicion, për reklamim që i bëjmë kësaj Komune të Dragashit, që të jetë në mesin e komunave të barabarta në Kosovë. I nderuar delegat, nuk kemi pas nevojë me marrë një punëtor për me i ngjit zarfet. Po meqenëse je delegat edhe e njeh mirë teknologjinë informative, hi kqyre, se e kemi një memorandum bashkëpunimi dhe kontratë me Postën e Kosovës. Deri më tash faturat e tatimit në pronë janë ndarë me dorë, tash e tutje ndahen përmes Postës. Të gjitha shpenzimet bëhen drejtpërdrejt prej Prishtinës. E vetmja mënyrë ligjore që njihet kur ka konteste ligjore, është kur i shkon me rekomandë fatura e tatimit në pronë.

Besoj që në kohën e duhur, kush ka fatura të tatimit në pronë, e ka marrë gjithashtu me zarf, të palosur, me rekomandë, i kanë marrë faturat e tatimit në pronë. Prandaj janë shtue këto shpenzime dhe ti mund ta shohësh edhe marrëveshjen të cilën e kemi të kontraktuar. I nderuar delegat, për subvencionet ke të drejtë të bësh politikë edhe mund të marrësh përgjigje politike. Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave është edhe ndihet e kënaqur që ka arrit të bëjë ndarjen e subvencioneve për entitetet jopublike dhe publike. Neve na vjen mirë që këto subvencione, para se me u nda, kanë shkue përmes procedurave të thirrjes publike, të cilat i ka vlerësue Komisioni, nuk i vlerëson Drejtorja e Ekonomisë dhe Financave. Ti ndoshta do të kishe pas dëshirë që unë të të jap përgjigje politike, por si drejtor i Ekonomisë dhe Financave nuk kam një përgjigje politike, po të jap një përgjigje procedurale. Në qoftë se duash përgjigje politike, mund të marrësh nga drejtoritë përkatëse të cilat e kanë bërë shpërndarjen e tyre. Mu më vjen keq, se unë edhe një numër të këtyre OJQ-ve që janë përfituese të këtyre subvencioneve, për fat të mirë nuk i njoh. Është më mirë që nuk i njoh, për faktin se nuk kam konflikt interesi. Kjo është me rëndësi për Drejtorinë e Ekonomisë dhe Financave. Meqenëse ju ia dini veprimtarinë, prejardhjen e individit, mos jeni rojtarë ju i këtyre OJQ-ve, që po operojnë me aktivitetet e tyre në Komunën e Dragashit. Unë besoj se deri më tash jemi të kënaqur me ato aktivitete që janë duke u zhvilluar. Ndoshta jo në mënyrën më të mirë të mundshme, po unë besoj që në mënyrë shumë të mirë deri më tash janë bo disa aktivitete. Sa i përket ujësjellësit, ju lutem Nexho, nuk po ta zë për të madhe, këtu i kemi investimet në ujësjellës, 31260, janë për të gjitha investimet në ujësjellës. I kje: Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Leshtan 13,429 euro; Ndërtimi i bazenit të ujit në vendin e quajtur ‘Kajqovce’, fshati Libevishtë...

Uran Halimi: Më fal, drejtor! Nuk ishte fjala për këtë ujësjellësin, por ishte fjala për ujësjellësin kryesor në Dragash. 137 mijë euro.

Qamil Kolloni: Prit ta përfundoj! 14,953. Ndërsa, ndërtimi i Ujësjellësit kryesor – Dragash, është Ujësjellësi kryesor të cilit i kemi ndarë 500 mijë euro mjete për tri kompani. Fazën e parë të cilën e kanë krye dhe i është bërë pagesa deri më tash dhe tash pritet të bahen edhe pagesa tjera, fatura e parë është 137,400.30 që është bërë kjo pagesë. Për Ujësjellësin e 15 fshatrave. Ujësjellësi kryesor – Dragash, është kështu i emërtuet. Ju lutem, është fjala për këtë ujë. Dhe, kur i mbledhish të gjitha, se ne e kemi ndarë kategorinë, shikone kodin aty, kush e ka materialin përpara. Te Ujësjellësi e kemi 31260, ky është kodi. Kur i mbledhish këto shuma, na vjen vlere 165,787.76 euro. Prandaj, shumë në mënyrë kolegjiale ju kam thënë edhe në fillim, kam kënaqësinë kur bëni pyetje, sepse si delegat është mirë të bëni pyetje, veç kur e merrni edhe rolin e gjykatësit edhe t’i gjykoni gjërat, atëherë kaloni ma tepër se që duhet. Pranadaj, ju lutem, nuk kemi nevojë – unë besoj, si drejtor i Ekonomisë dhe Financave, çdo vendim që e keni marrë ju, jemi mundue me përpikëri me e ekzekutue. Nuk ka nevojë

këtu të bëjmë kurrfarë polemike. Prandaj, në qoftë se kam harrue edhe të kam mbet diku pa u përgjigj, të kërkoj falje, mirëpo shfrytëzoje të drejtën tënde...

Uran Halimi: E ka pas edhe një pyetje, Demokratska Omladina Gore këtu është në dy vende, në një vend i ka marrë 2 mijë euro edhe një vend 3 mijë euro.

Qamil Kolloni: Kryesues, në qoftë se më dëgjove me vëmendje, aty ka mund tri herë edhe katër herë, Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave i ndan mjetet. Drejtoritë tjera i përcjellin procedurat dhe bëjnë thirrje publike. Në kuadër të thirrjeve publike, të gjitha OJQ-të konkurrojnë me programet e veta. Në qoftë se komisioni për vlerësim u jep të drejtën që i plotësojnë kriteret të cilat janë vu për marrjen e atij subvencioni, vendos komisioni dhe ne jemi të obliguar se DEF që ta bëjmë pagesën. Pra, na as nuk e japim, as nuk e përjashtojmë. Janë kriteret të cilat vihen për dhënien e subvencioneve, varësisht prej aktiviteteve të cilat mbahen në Komunë dhe varësisht në cilin drejtorat. Për këtë arsye, unë munda me të dhënë përgjigje politike, por unë nuk po due me u lëshue në rrethana politike. Këto janë procedurat me të cilat DEF i kryen obligimet ndaj OJQ-ve.

Uran Halimi: Falemnderit, drejtor! I ka vetëm dy minuta replikë z.Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Në të gjithë fjalimin tuaj ju u mbështetët në fjalime politike dhe ju vetë na mbajtët një fjalim gjithëpërfshirës politik. Pak më parë thatë se janë shtuar mjetet për informim publik sepse kemi pasur ekspozitën e biznesmenëve Expo Shari, ju keni shtypur broshura atëherë, i keni dhënë edhe 13 mijë euro. A nuk përfshihen ato broshura në ato 13,000 euro? Nuk mund ta kuptoj që komuna i jep para një organizate joqeveritare për një projekt, pastaj u jep traktorë, pastaj u jep traktorë, pastaj shtyp broshura për ta. Çfarë do të bëjnë atëherë për ne organizatat joqeveritare? Unë nuk mund ta kuptoj atë. Kemi një rast me ata që organizuan ekspozitën, të cilën unë e kam mbështetur atë ekspozitë, kanë marrë 13 mijë euro dhe ne duhet t'u shtypim broshura. Atëherë lind pyetja se pse i kanë marrë ato 13 mijë euro. Kemi një OJQ që ka marrë 186 mijë euro, i japim traktorë, i mbushim me karburant dhe i marrin lekët. Kur bëj një pyetje, nuk po pyes pse u keni dhënë para, por pse nuk i kontrolloni. Rinia Demokratike e Gore u përjashtua fillimisht nga gara. Në raportin që kam, Rinia Demokratike e Gorës nuk i plotësoi kushtet për të marrë asnjë cent. Pas kësaj, kur ju subvencionuat SENSEA-n, Rinia Demokratike e Gore u shfaq me 2000 euro të tjera dhe publiku nuk u informua për këtë. Në bazë të cilit ligj u janë ndarë ato mjete. Nuk kam dyshim që ke gabuar me doren tënde, mbase ka gabuar shefi i komisionit, nuk kam dyshim për këtë, sepse ai gjithmone ben gabime te tilla, i perkëdheluri i kryetarit, sherbetori i tij, që e ndjek pas kryetarit dhe mban të mbyllur zyrën e komunitetit. Në dy vite ai nuk ka qenë kurrë në zyrën e tij, këtë duhet ta dijë populli. Mua më intereson se si kanë hyrë ato 2000 euro në xhepat e organizatës joqeveritare DOG. Ata nuk i plotësonin kërkesat.

Komisioni i hodhi poshtë. Në fund i marrin 2000 euro, nuk mund t'ua japë kryetari atë shumë, jo pa procedura dhe nuk e kanë kaluar komisionin për politikë dhe financa. Ju ende më keni borxh një përgjigje për 117,000 euro në lidhje me shërbimet e kontraktuara. Nuk me ktheve përgjigje për pajisjet e tjera rreth 20000 euro. E sa i përket pullave, do të thotë se ata nga Prishtina i lëpin pullat.

Qamil Kolloni: Nexho, kur nuk dish edhe pyesish, është normale mos me ditë. Veç kur fillon me t'u rras mendja se po dijs, atëherë kemi pak problem. Problemi këtu qëndron, Nexhë, se unë e thashë, panairi është organizue në Prishtinë. Për shpenzimet e patëm fjalën, mos i përzij subvencionet me shpenzimet, se shpenzimet e informimit nuk kanë subvencionet, po kanë shpenzimet e informimit. Ndërsa sa i përket panairit, që është organizue nga Shoqata e Afaristëve të Komunës së Dragashit, në 13 mijë euro vlerë, ai i është nënshtrur procedurave publike, të cilën e ka marrë në mënyrë të rregullt dhe ata raportojnë për shpenzimet të cilat i krijojnë. Unë fola për shpenzimet që Komuna është përfaqësue në Panairin në Prishtinë, në sallën "11 Tetori", ku kanë marrë pjesë katër biznese në emër të zhvillimit të turizmit në Komunën tonë. Tash për produkte vendore do të marrin edhe katër biznese të tjera. Në ndërkohë, shpenzimet e informimit që bëhen gjatë dy ditëve në atë panair, kanë një kosto të vet dhe i kemi shti në këto shpenzime. Këto kanë reflektue në shpenzimet e informimit, ku marrin pjesë edhe mediumet të cilat janë këtu dhe këto janë ato shpenzimet të cilat kanë reflektue. Sa i përket kodit për shpenzimet kontraktuale, paskam harrue me të dhënë, por po të jap përgjigje. Kemi angazhimin e punëtorëve të ambientit, të pastrimit, të mirëmbajtjes të parqeve, të gjithë punëtorët të cilët janë të kontraktuar. Kemi angazhimin e mjekëve dhe angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Pra këto janë ato mjete të cilat kanë rezultue dhe jemi duke i kryer në mënyrën më të mirë të mundshme. Unë besoj se edhe për këto, kur kemi pas në seancat e mëhershme, edhe në tremujorshin e parë kur i kemi paraqit këto marrëveshje që duhet t'i zbatojmë për me i ik auditimit edhe keqklasifikimit, kemi ardhë në ujdi me qeta delegatë. Prandaj, mu po më vjen keq që shumë shpejt po harroni edhe po na qitni në një pozitë të palakmueshme. Kur e bojsh pyetjen kam kënaqësi, por kur po më gjykojsh edhe kur po fillojsh me dhënë kualifikime politike, atëherë po më qesish në një pozitë të palakmueshme që po më detyrojsh ndoshta nganjëherë, përkundër vullnetit, me e përdorë një fjalor ndryshe.

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë prezentë! Po ju them veç një fakt: Këtu dikush po don me e lujt rolin e cirkut. Na qaq naivë e budallë nuk jemi. Duhet me i ngrit çështjet aty ku më të vërtetë ka dyshime. Jo me dalë në opinion këtu edhe me na pa publiku, se ata nuk e dinë, nuk i dinë dokumentet, se kërkush nuk i posedon këto dokumente përveç neve zyrtarëve. Këtu u fol në baza nacionale edhe zv/kryesuesi më zhgënjeu kur dha argument pa e ditë rastin. Nedžmidini tash në baza nacionale e sulmoi drejtorin tim. Njëjtë veptoi sikur unë që i kam thënë Nedžmidinit po rrejsh. Me dokumentin

që e ka pas të rrejshëm, se nuk ka qenë kjo legjislaturë. Domethënë Nedžmidini personalisht edhe të tjerët që po mundohen, një gjë po ju them: Prej shpalljes së Pavarësisë, kur ka qenë UNMIK-u, e deri sot, u punue shumë e s'po vidhet hiç. Që dy vjet u punue shumë, e s'po vidhet hiç. Edhe një herë po e përsëris, u punue shumë e s'po vidhet hiç. Edhe në qoftë se keni argument kush po bën keqpërdorime, neve krejtve po na duhet, edhe kryetarit, edhe qeverisë edhe neve krejtve po na duhet argumenti, jo rrena, jo shpifja, jo dallaveret. Dilni me fakte edhe unë jam i pari qaj që kam me e ngrit zërin kundër vetes time edhe vëllait tim edhe qeverisë time. E jo me bo lajka, me nije njerëzit atje, t'u u mundue me i dezinformue. Personi në fjalë ka thënë pse s'i keni dhënë Demokratska Omladina Gorës subvencione, tash po çohet po thotë pse i keni dhënë. Kjo është dyfytërësi, munafikllëk, edhe i thashë parëz. Unë e kam dëgjue diskutimin kur e kanë bo atëherë, pse s'i keni dhënë, tash pse i keni dhënë. S'e di, s'po kuptoj. Edhe drejtori i Financave, jepi argumentet qysh janë edhe për çka me u ndie fajtor, mos e ndiej veten fajtor edhe viktimë. Jo zotëri, se ke argumente edhe ke fakte, pastër, Në qoftë se kanë këta argumente ... me zor po presin me na qit neve qetu. Faleminderit shumë!

Uran Halimi: Sa i përket Raportit, ma herët kam nije që është raport, a votohet a jo s'ka rëndësi. Kështu që, në mungesë të kuorumit na duhet me e mbyllë këtë seancë. Sipas rregullave të Kuvendit. Falemnderit shumë!

Kryesuesi i Kuvendit

Uran Halimi